



Vlerësimi Institucional i Institucioneve të Arsimit të Lartë në Shqipëri

**Raporti i Universitetit të
Mjekësisë, Tiranë**

Maj 2017

GRUPI I VLERËSIMIT TË JASHTËM:

- | | | |
|---|------------------------|----------|
| 1 | Alison Blackburn | Kryetare |
| 2 | Profesor Mark Davies | Anëtar |
| 3 | Profesor Anila Hoda | Anëtare |
| 4 | Profesor Thoma Korini | Anëtar |
| 5 | Profesor Chris Maguire | Anëtar |
| 6 | Dr. Carol Vielba | Anëtar |

Alison Blackburn

Mark Davies

Anila Hoda

Thoma Korini

Chris Maguire

Carol Vielba

Datë: 10-12 maj 2017

Përmbajtja

| | |
|-----------------------------------------------------------------------|-------------------------------------|
| Rreth këtij Vlerësimi | Error! Bookmark not defined. |
| Konteksti i këtij vlerësimi..... | Error! Bookmark not defined. |
| Raport i përmbledhur | Error! Bookmark not defined. |
| Përmbledhje e gjetjeve | Error! Bookmark not defined. |
| Raporti i detajuar | Error! Bookmark not defined. |
| Fusha e Vlerësimit 1: Organizimi dhe Menaxhimi i tij | Error! Bookmark not defined. |
| Fusha e Vlerësimit 2: Burimet..... | Error! Bookmark not defined. |
| Fusha e Vlerësimit 3: Kurrikula | Error! Bookmark not defined. |
| Fusha e Vlerësimit 4: Mësimdhënia, Mësimnxënia, Vlerësimi dhe Kërkimi | Error! Bookmark not defined. |
| Fusha e Vlerësimit 5: Studentët dhe Mbështetja e tyre | Error! Bookmark not defined. |

Rreth këtij vlerësimi

Qëllimi i përgjithshëm i Vlerësimit Institucional është të vlerësojë në çfarë shkalle IAL-ja përmbush Standardet Shtetërore Shqiptare të Cilësisë, të hyra në fuqi në 2011-n. Vlerësimi i jashtëm institucional është një proces i vlerësimit me ekspertë të jashtëm, ku çdo grup ekspertësh përbëhet nga ekspertë të Mbretërisë së Bashkuar, të caktuar nga QAA-ja, dhe nga ekspertë shqiptarë të caktuar nga Agjencia Publike e Akreditimit të Arsimit të Lartë (APAAL). Grupi i Vlerësimit të Jashtëm drejtohet nga një ekspert i QAA-së.

Raportet përfundimtare do të shërbejnë jo vetëm për akreditimin institucional, bazuar në shkallën e përmbushjes së Standardeve nga IAL-ja, por edhe për të informuar IAL-të, qeverinë shqiptare, publikun dhe studentët, se si IAL-ja i përmbush Standardet. Ky raport, i ndihmon gjithashtu IAL-të që të identifikojnë përparësitë për përmirësime (procesi që ofruhet e arsimit të lartë zbatohet për përmirësimin sistematik të cilësisë së ofrimit dhe mënyrave për mbështetjen e të nxënësve të studentëve). Standardet Shtetërore të Cilësisë në Shqipëri janë grupuar nën pesë Fusha Vlerësimi: Organizimi dhe Menaxhimi i tij; Burimet; Kurrikula; Mësimdhënia, Mësimnxënia, Vlerësimi dhe Kërkimi; si dhe Studentët dhe Mbështetja e tyre. Ky raport identifikon karakteristikat e praktikave më të mira, rekomandimet, pohimet e veprimtarisë në zhvillim e sipër dhe dobësitë për çdo Fushë Vlerësimi, përfshirë gjykimin se në çfarë niveli IAL-ja i përmbush Standardet. Format e gjykimit që ekspertët mund të japin janë: Standardet janë përmbushur plotësisht; Standardet janë përmbushur kryesisht; Standardet janë përmbushur pjesërisht; ose Standardet nuk janë përmbushur.

Në fund, ekspertët do ta përmbyllin punën e tyre duke i rekomanduar Këshillit të Akreditimit të APAAL-it një gjykim të përmbledhur. Gjykimi i përmbledhur është një nga katër nivelet e mëposhtme:

- **Standardet Shtetërore të Cilësisë janë përmbushur plotësisht**
- **Standardet Shtetërore të Cilësisë janë përmbushur kryesisht**
- **Standardet Shtetërore të Cilësisë janë përmbushur pjesërisht**
- **Standardet Shtetërore të Cilësisë nuk janë përmbushur**

Në kuadrin e procesit të përgatitjes së raportit, QAA-ja ka siguruar ekspertë mbështetës për Grupin e Vlerësimit të Jashtëm duke siguruar që grupi t'i mbështesë gjetjet në raport me fakte, si dhe për korrektimin dhe përmbledhjen e raportit të plotë për përmbledhjen që vijon.

Konteksti i këtij vlerësimi

Universiteti i Mjekësisë Tiranë, është institucion publik i arsimit të lartë, që e ka zanafillën nga Instituti i Lartë i Mjekësisë, themeluar në vitin 1952. Instituti u bë pjesë e Universitetit të Tiranës, si Fakulteti i Mjekësisë, në vitin 1957. Fakulteti i Mjekësisë dhe Fakulteti i Shkencave Teknike, që më vonë u nda nga Universiteti i Tiranës për t'u themeluar si Universiteti i Mjekësisë Tiranë, në vitin 2013.

Universiteti përbëhet nga tre fakultete: Fakulteti i Mjekësisë; Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike; dhe Fakulteti i Mjekësisë Dentare. Në varësi të fakulteteve ka 22 departamente. Universiteti ofron studime të ciklit të parë, të dytë dhe të tretë, të cilat zhvillohen në gjuhën shqipe. Fakulteti i Mjekësisë ofron: studime të ciklit të parë, në nivelin bachelor, në Shëndet Publik; studime të ciklit të dytë në nivelin master në Shëndet Publik dhe programe të integruara studimi në Mjekësi të Përgjithshme dhe Farmaci; dhe programe specializimi dhe doktorature në Mjekësi. Fakulteti i Mjekësisë Dentare ofron një diplomë të integruar (Master në Stomatologji), programet e specializimit dhe ato të doktoraturës, të ciklit të dytë dhe të tretë. Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike ofron studime të nivelit bachelor dhe master (programe të ciklit të parë dhe të dytë) në Infermieri, Mami, Fizioterapi, Imazheri, Teknik Laboratori dhe Logopedi dhe studime të ciklit të tretë, si dhe Doktoraturë në të gjitha këto degë.

Misioni i Universitetit është t'i formojë studentët në fushat e shkencave mjekësore, në të tria ciklet e studimit, sipas standardeve më të larta profesionale; të përgatisë profesionistë që janë të aftë të ofrojnë kujdes optimal ndaj pacientëve; të parandalojë dhe të trajtojë sëmundjet; dhe të përparojë me kërkimin shkencor. **[RVV fq. 30; 1.0]**

Raport i përmbledhur

Një ekip nga universiteti përpiloi raportin e vetëvlerësimit, që përfshinte drejtuesit e nivelit të lartë, stafin akademik dhe administrativ, dhe një përfaqësues të studentëve. Projekt raportet iu shpërndanë një audience më të gjerë, përpara përfundimit dhe miratimit të raportit të vetëvlerësimit, nga Rektori dhe grupi i përpilimit. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm e konsideroi raportin si shumë të dobishëm dhe mjaft autokritik.

Vizita u krye përgjatë dy ditëve e gjysmë. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm përbëhej nga katër ekspertë të nivelit të lartë për arsimin e lartë, nga Mbretëria e Bashkuar, dhe nga dy anëtarë me përvojë në arsimin e lartë, nga stafi i institucionit shqiptar. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm u mbështet nga Menaxheri i Vlerësimit dhe mbajtësi i shënimeve, të siguruar nga APAAL-i, agjencia përgjegjëse për vlerësimet e arsimit të lartë në Shqipëri. Grupit të Vlerësimit të Jashtëm iu vu në dispozicion Raporti i Vetëvlerësimit (RVV) dhe një dosje me dokumente mbështetëse, tetë javë përpara fillimit të vizitës së vlerësimit, të plotësuar nga dokumentet shtesë të kërkuara. Gjithsej, u morën në konsideratë 178 dokumente, të cilat e ndihmuan grupin e vlerësimit që të njihet me strukturën, politikën, procedurat e menaxhimit, strukturat dhe me mënyrën e mësimdhënies dhe veprimtarisë kërkimore, të ndërmarrë nga Universiteti. Dokumentet e shqyrtuara përfshinin: Statutin e Universitetit; Rregulloret Akademike; Raportet Vjetore; procedurat e pranimit dhe orientimit; gamën e marrëveshjeve të jashtme; shembuj të informacionit mbi programin dhe dokumentacion të mbledhjeve vendimmarrëse.

Gjatë vizitës së vlerësimit, u organizuan një sërë takimesh, që i mundësuan Grupit të Vlerësimit të Jashtëm që të kuptojë më qartë përgjegjësitë, procedurat dhe pikëpamjet e stafit dhe studentëve. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm u takua me Rektoren, drejtuesit e lartë, studentët, stafin akademik e administrativ dhe personelin mbështetës. Gjatë takimeve u mbajtën shënime. Gjatë turit në kampusin e universitetit, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm vizitoi bibliotekën, auditorët, hapësirat e praktikës klinike dhe laboratorët, dhe pati mundësinë të vrojtonte sistemet elektronike të informacionit për stafin dhe studentët. Pas vlerësimit të të gjitha dokumenteve të vëna në dispozicion, grupi arriti përfundimet që do shtjellohen më poshtë.

Universiteti i përmbush plotësisht Standardet për Organizimin dhe Menaxhimin e tij. Organizimi i Universitetit përcaktohet në Statutin dhe në Rregulloret e tij; në mbledhjet zyrtare ndiqen procedura dhe protokolle të përcaktuara. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi karakteristika të praktikës së mirë për sa i përket marrëdhënieve të ngushta të bashkëpunimit, që Universiteti i ka zhvilluar me sektorin e shëndetësisë. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm pohoi përpjekjen e Universitetit për të plotësuar kërkesat e ligjit nr. 80/2015 dhe hapat e ndërmarra, për të forcuar cilësinë e vlerësimit dhe Standardet, nëpërmjet themelimit të Njësisë së Brendshme të Sigurimit të Cilësisë. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi asnjë dobësi dhe nuk dha rekomandime.

Universiteti i përmbush plotësisht Standardet për Burimet. Përgjegjësitë për burimet janë qartësisht të përcaktuara në Statutin dhe në Rregulloret e Universitetit dhe ato përmbushen në mënyrë të përshtatshme nga Rektori, Senati Akademik dhe Bordi i Administrimit. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm vuri re se Universiteti është në gjendje të tërheqë një gamë të gjerë burimesh dhe mbështetje nga sektori i shëndetësisë, dhe përfiton, në veçanti, nga afërsia fizike me Spitalin Universitar “Nënë Tereza” dhe strukturat spitalore. Kjo i ofron një shtrirje burimesh të vazhdueshme dhe të pasura, për stafin dhe studentët. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi karakteristika të praktikës së mirë, nuk identifikoi ndonjë dobësi, nuk dha rekomandime, ose nuk bëri pohime.

Universiteti i përmbush plotësisht Standardet për Kurrikulën. Siç i takon mjekësisë dhe subjekteve të tjera të lidhura me mjekësinë, kurrikula është e lidhur ngushtësisht me

kërkesat e profesionit dhe mbështetet nga një rrjet i fuqishëm mjekësh dhe organesh profesionale. Programet e studimit janë qartësisht të përcaktuara dhe të përshtatshme, dhe studentëve iu jepet informacioni në kohën e duhur. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi karakteristika të praktikës së mirë, nuk identifikoi ndonjë dobësi, nuk dha rekomandime, ose nuk bëri pohime.

Universiteti i përmbush kryesisht Standardet për Mësimdhënien, Mësimnxënien, Vlerësimin dhe Kërkimin. Rregullat dhe kërkesat e studimit janë të përcaktuara qartësisht në Rregulloren e Universitetit, dhe vihet re një marrëdhënie e fortë me praktikën profesionale, ku pjesa më e madhe e orëve mësimore zhvillohen në bashkëpunim me organizata të tjera. Megjithatë, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm e identifikoi si dobësi mungesën e një qasje të efektshme në të gjithë universitetin, për të nxitur përmirësimin e vazhdueshëm në cilësinë e mësimdhënies si për stafin e ri, ashtu edhe për atë me përvojë. Rekomandohet që universiteti të zbatojë një sistem të efektshëm, së bashku me procedurat përkatëse, për ta zhvilluar stafin akademik në mësimdhënie, mësimnxënie dhe vlerësim, duke marrë parasysh praktikatat e mira aktuale. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi karakteristika të praktikës së mirë dhe nuk bëri pohime.

Universiteti i përmbush plotësisht Standardet për Studentët dhe Mbështetjen e tyre. Studentët përfitojnë nga marrëdhëniet e ngushta me stafin akademik dhe nga aksesimi në një rrjet i fuqishëm mjekësh. Studentët mbështeten dhe kanë akses në një gamë të gjerë të aktiviteteve sociale dhe komunitare, nëpërmjet Këshillit Studentor. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm pohoi hapat që po ndërmerren aktualisht nga Universiteti, për të forcuar mbështetjen ndaj karrierës dhe mbledhjen e të dhënave statistikore mbi punësimin e të diplomuarve.

Përmbledhje e gjetjeve

Praktika e mirë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi karakteristikën e mëposhtme të praktikës së mirë.

- Marrëdhëniet e ngushta bashkëpunuese të efektshme, që Universiteti ka zhvilluar me sektorin e shëndetësisë (pikat 1.22 dhe 4.1; **Kapitulli, III, Standardi III.3**)

Dobësitë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi dobësinë e mëposhtme:

- Mungesa e një qasjeje të efektshme në të gjithë universitetin, për të nxitur përmirësimin e vazhdueshëm në cilësinë e mësimdhënies si për stafin e ri, ashtu edhe për atë me përvojë (pikat 4.13 dhe 4.14; **Kapitulli, II, Standardi I.1**).

Rekomandime

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm dha rekomandimin e mëposhtëm:

- Universiteti duhet të zbatojë një sistem të efektshëm së bashku me procedurat përkatëse, për ta zhvilluar stafin akademik në mësimdhënie, mësimnxënie dhe vlerësim, duke marrë parasysh praktikatat e mira aktuale (pika 4.14; **Kapitulli, II, Standardi I.1**).

Pohimi i veprimeve të ndërmarra

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm pohon se veprimet e mëposhtme po ndërmerren aktualisht:

- Puna që po ndërmerret për të përmbushur kërkesat e ligjit nr. 80/2015 (pika 1.1; **Kapitulli, III Standardi I.1**)
- Hapat e ndërmarra, për të forcuar cilësinë e vlerësimit dhe Standardet, nëpërmjet themelimit të Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (pikat 1.8 dhe 4.23; **Kapitulli, III, Standardi I.4**)
- Hapat që po ndërmerren aktualisht nga Universiteti, për të forcuar mbështetjen ndaj karrierës dhe mbledhjen e të dhënave statistikore mbi punësimin e të diplomuarve (pikat 5.12. 3.9 dhe 4.12; **Kapitulli, I, Standardi III.9**).

Përmbledhje e gjykimeve për çdo Fushë Vlerësimi

- 1 Standardet për Organizimin dhe Menaxhimin e tij janë përmbushur **plotësisht**.
- 2 Standardet për Burimet janë përmbushur **plotësisht**.
- 3 Standardet për Kurrikulën janë përmbushur **plotësisht**.
- 4 Standardet për Mësimdhënien, Mësimnxënien, Vlerësimin dhe Kërkimin janë **përmbushur kryesisht**.
- 5 Standardet për Studentët dhe Mbështetjes së tyre janë përmbushur **plotësisht**.

Gjykim i përmbledhur

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm i rekomandon Këshillit të Akreditimit se në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë, Standardet Shtetërore të Cilësisë janë përmbushur **plotësisht**.

Raporti i detajuar

Fusha e Vlerësimit 1: Organizimi dhe Menaxhimi i tij

- 1.1 Universiteti i Mjekësisë Tiranë, u themelua në vitin 2013, me Vendim të Këshillit të Ministrave. Ai ka statutet e veta, që janë hartuar në përputhje me misionin e Universitetit dhe reflektojnë dispozitat e Ligjit të ri për Arsimin e Lartë. **[1.0]** Institucioni dhe strukturat e tij funksionojnë në zbatim të statuteve. Statutet janë ndryshuar ndër vite nga Senati, me qëllim pasqyrimin e ndryshimeve legjislative dhe lehtësimin e përmirësimit të funksionimit të Universitetit. **[Vendimi i datës 19.03.2016, përmendur në RVV]** Përpos statuteve, Universiteti ka një sërë rregulloresh formale, të cilat përbëjnë bazën e strukturës, organizimit dhe funksionimit të Universitetit, si edhe përcaktojnë të drejtat dhe detyrimet e stafit dhe studentëve. **[3.0]** Rregulloret përditësohen nga Senati, sipas nevojës. Ligji i ri për Arsimin e Lartë nr. 80/2015 parashikon ndryshime si në statutet, ashtu edhe në rregulloret. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm pohoi se janë ndërmarrë veprime për të përmbushur kërkesat e ligjit nr. 80/2015. Për trajtimin e kësaj çështje, në mars të vitit 2017, u ngrit një grup pune. **[FE1.4.1]** Hartimi i projektstatuteve ka përfunduar. Projektstatutet janë aktualisht në fazën e konsultimit të brendshëm përpara miratimit nga Senati brenda këtij viti dhe dorëzimit në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit. **[M1]** Pritet të bëhen ndryshime edhe në rregulloret, sipas kërkesave të ligjit. **[Kapitulli, III, Standardi I.1]**
- 1.2 Organizimi i Universitetit përcaktohet në statutet dhe rregulloret, dhe bazohet në tre organe kyçe: Rektorati, Senati dhe Bordi i Administrimit. Rektorati, i përbërë nga Rektori, Zëvendës Rektori dhe departamentet qendrore të administrimit dhe drejtoritë, është përgjegjës për menaxhimin e përgjithshëm të institucionit. **[1.0; 18.0; 18.2]** Rektori zgjidhet nga stafi me kohë të plotë dhe nga studentët, për një mandat katër-vjeçar. Senati, i kryesuar nga Rektori, është autoriteti më i lartë akademik i Universitetit dhe përbëhet nga përfaqësues të stafit dhe studentëve. **[7.0]** Bordi i Administrimit, ish Këshilli i Administrimit, mbikëqyr çështjet financiare dhe administrative dhe bashkëpunon me Senatin dhe Rektoratin, për të hartuar buxhetin dhe planet e burimeve. **[8.0]** Një organ i katërt i zgjidhur është Këshilli i Etikës, që këshillon për çështjet e etikës dhe Standardeve të jetës akademike, si edhe shqyrton nëse janë shkelur dispozitat e Kodit të Etikës së Universitetit. **[15; FE Indeksi i dokumenteve të vëna në dispozicion; AE5; M7]**
- 1.3 Universiteti ndahet në tre fakultete dhe secili prej tyre drejtohet nga një dekan i zgjedhur. Secili fakultet i përmbahet disa normave formale, që rrjedhin nga statutet dhe rregulloret e Universitetit. **[3.1]** Nën varësinë e fakulteteve janë 22 departamente, dhe secili drejtohet nga një përgjegjës i zgjedhur. Sipas legjislacionit të mëparshëm, çdo fakultet kishte një Këshill Kolegjial të Fakultetit, i cili, ndër të tjera, mbikëqyrte hartimin dhe dorëzimin e programeve të studimit dhe drejtimin e përgjithshëm të fakultetit. Këto përgjegjësi i kanë kaluar dekanëve, në pritje të zbatimit të statuteve dhe rregulloreve të reja, përmendur më sipër (pika 1.1). **[M1]** Ndryshimet legjislative kanë sjellë rrjedhimisht pezullimin e Këshillave të Profesorëve në nivel fakulteti, që luanin një rol kyç në dhënien e gradës shkencore të doktoraturës dhe në dhënien e titujve "Profesor". **[4.0; 4.1]** Është ngritur një strukturë e re, për të trajtuar promovimin e stafit; megjithatë, dhënia e gradës shkencore aktualisht është lënë pezull, deri sa të dalë udhëzimi nga qeveria e re dhe deri sa të krijohen strukturat, në nivel departamenti, në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 80/2015. Rektori është shprehur se çështja e vonësive të mundshme në dhënien e gradave shkencore, si pasojë e ndryshimeve në kuadrin ligjor, po trajtohet si një çështje e ngutshme. **[M1]**

- 1.4 Para disa kohësh u mbajtën zgjedhjet për pozicionet e sipërpërmendura dhe për organet e rëndësishme, si Senati dhe Bordi i Administrimit. Dokumentet dëshmuese të paraqitura nga Universiteti, si edhe diskutimet midis stafit dhe studentëve, tregojnë se struktura e institucionit është e përshtatshme, dhe menaxhimi i tij është efikas. **[Kapitulli, III, Standardi I.2]**
- 1.5 Senati, Bordi i Administrimit dhe organe të tjera të Universitetit organizojnë rregullisht mbledhje. Ato funksionojnë sipas rregulloreve të Universitetit, në të cilat përcaktohet roli, qëllimi dhe mënyra e funksionimit të tyre. **[7.0;8.0]** Vitin e kaluar, Senati është mbledhur në më shumë se dymbëdhjetë raste dhe ka vepruar nëpërmjet qarkoreve. **[Ev 7.1]** Në këto mbledhje janë marrë më shumë se 100 vendime zyrtare. Universiteti ka hartuar procedura dhe protokolle për organizimin e mbledhjeve, grumbullimin e shkresave, mbajtjen e procesverbaleve dhe shpërndarjen e vendimeve, si për Senatin, ashtu edhe për Bordin e Administrimit. **[7.3; 8.3; 8.4]**
- 1.6 Universiteti ka sisteme të efektshme për të njoftuar stafin dhe studentët rreth çështjeve që do të diskutohen, për të cilat do të merren vendime nga Senati, dhe për përcjelljen e vendimeve të Senatit, proces që u konfirmua si i suksesshëm nga ata që u takuan me Grupin. **[M5;M7]** Mbledhjet e departamenteve, si edhe zyrat e dekanëve në nivel fakulteti, luajnë një rol kyç në mbështetjen e punës së Senatit dhe organeve të tjera dhe në ndjekjen e zbatimit të vendimeve të marra. **[Kapitulli, III, Standardi I.3]**
- 1.7 Autonomia e Universitetit, për sa i përket botës së jashtme, garantohet nga Ligji për Arsimin e Lartë. Autonomia e Universitetit, së brendshmi, garantohet me anë të statuteve dhe rregulloreve. Universiteti i nënshtrohet auditimit të brendshëm dhe atij të jashtëm. Auditimi i jashtëm, që realizohet nga Ministria e Arsimit dhe Sportit, përqendrohet në sistemet e kontrollit, vlerësimin e rrezikut dhe efektshmërinë e sistemeve, në nivel qendror dhe nivel fakulteti. **[FE 2.2]** Universiteti ka Njësinë e vet të Auditimit, që kryen auditime të brendshme, që përqendrohen në efektshmërinë e kontrolleve dhe proceset e menaxhimit. **[FE 1.10]**
- 1.8 Për ta përforcuar vlerësimin e Universitetit kundrejt cilësisë së standardeve të ofrimit të shërbimeve, së fundmi është themeluar Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NjSBC). **[17.0]** Mbikëqyrja e punës së Njësisë realizohet nga një grup i drejtuar nga zëvendës dekani, që përfshin stafin akademik, një student dhe një ekspert të jashtëm. Mbështetja e nevojshme teknike, që Njësia të luajë rolin e saj, ofrohet nga dy burime qendrore administrative, nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve dhe Departamenti i Kurrikulës dhe Menaxhimit Akademik. Fillimisht, Njësia ka një mandat katër-vjeçar. NjSBC-ja ka si qëllim, të kryejë vlerësime periodike të mësimdhënies dhe veprimtarisë kërkimore, në përputhje me kuadrin e ofruar nga Agjencia Publike e Akreditimit të Arsimit të Lartë (APAAL). Si pjesë e procesit, janë hartuar pyetësorë për stafin dhe studentët. **[M7]** Grupi i Vlerësimit të Jashtëm **pohon** hapat e ndërmarrë, për të fuqizuar vlerësimin e cilësisë dhe standardeve, nëpërmjet krijimit të NjSBC-së, ndikimi i së cilës nuk është evidentuar ende.
- 1.9 Sektori i komunikimit në Departamentin e Kurrikulës dhe Standardeve administron projektet e universitetit, përfshirë kërkesat për bashkëpunim ndërkombëtar dhe financim. Universiteti ka një sërë marrëveshjesh që nxisin shkëmbimin dhe bashkëpunimin me universitete evropiane dhe agjenci të tjera. **[21; 21.1; 21.2]** Ai merr pjesë në një numër të konsiderueshëm projektesh, të financuara nga jashtë vendit. **[23.0]** **[Kapitulli, III Standardi I.4]**
- 1.10 Strategjia e re institucionale, për vitet 2017-2020, është konsoliduar, duke zëvendësuar strategjinë e mëparshme, për vitet 2013-2016. **[2.1; 2.2]** Strategjia e re është hartuar, për të pasqyruar misionin dhe synimin e Universitetit, në kontekstin e

kuadrit të ri ligjor, si edhe për të qenë në koherencë me zhvillimet në shkencat mjekësore dhe kontekstin më të gjerë të arsimit të lartë. Strategjia përcakton qartësisht qëllimet dhe objektivat, si edhe planet e veprimit me afatet e realizimit për sa i përket studentëve, stafit dhe ndërkombëtarizimit, financimit dhe strukturave, dhe organizimit të universitetit. Për strategjinë e re është diskutuar gjerësisht në të gjitha nivelet, me stafin dhe studentët, përpara se të miratohej nga Senati. **[Kapitulli, III, Standardi I.5]**

- 1.11 Universiteti publikon një raport vjetor, në nivel institucional, për veprimtarinë akademike, kërkimore dhe financiare. **[16]** Raporti përpilohet në bazë të raporteve vjetore të të gjithë fakulteteve. **[16.1]** Për raportin diskutohet në të gjitha nivelet e universitetit, dhe më pas ai paraqitet në një takim të hapur, të organizuar nga Senati. **[M9]** Raporti përmban analizë të detajuar të të dhënave statistikore dhe cilësore të veprimtarisë, përfshirë krahasime me vite të mëparshme, si edhe komente cilësore. Raporti përfundimtar i dakordësuar publikohet në faqen e internetit të Universitetit [\[http://umed.edu.al/universiteti/dokumenta-per-umt\]](http://umed.edu.al/universiteti/dokumenta-per-umt), ndërsa një kopje e tij i dorëzohet Ministrisë së Arsimit dhe Sportit.
- 1.12 Raporti përfundon me hartimin e një plani veprimi nga Rektorati. **[AE4]** Plani përpilohet nga Zëvendës Rektori për Kërkimin Shkencor, Drejtuesi i NjSBC dhe Drejtuesi i Njësisë së Auditimit. Pasi miratimit nga Rektorati, fakulteteve, departamenteve dhe njësisve e tjera, u jepet një afat kohor për zbatimin e veprimeve të rëna dakord. Progresi monitorohet nga Zëvendës Rektori për Menaxhimin Akademik dhe Kurrikulën, i cili i raporton rregullisht Rektoratit. **[Kapitulli, III, Standardi I.6]**
- 1.13 Liria akademike parashikohet në statutet dhe rregulloret e universitetit. **[1.0; 3.0]** Ajo realizohet: nëpërmjet delegimit të përgjegjësive të fakultetet dhe departamentet; nëpërmjet emërimit të stafit të kualifikuar; nëpërmjet nxitjes së bursave dhe kërkimeve të pavarura; dhe nëpërmjet proceseve zyrtare të vendosura, që janë hartuar për të siguruar si fondin, ashtu edhe rëndësinë e mësimdhënies dhe vlerësimin e drejtë. Parimi i lirisë akademike përcakton përgjegjësitë, me të cilat është ngarkuar i gjithë stafi, nëpërmjet Kodit të Etikës së universitetit. **[15.0]** Stafi ka të drejtë që të organizojë mësimdhënien, studimin dhe bursat e tyre, në mënyrë të pavarur, brenda kornizës që përcaktohet nga misioni dhe qëllimi i universitetit dhe politikat e rëna dakord të departamentit të tyre. **[M7]** Universiteti shfrytëzon autonominë e tij, për të ndjekur misionin e tij, duke nënshkruar marrëveshje me institucionet e arsimit të lartë dhe me organizata të tjera të së njëjtës fushë, në nivel vendor, kombëtar dhe ndërkombëtar.
- 1.14 Universiteti ka një staf akademik me kohë të plotë prej rreth 300 anëtarësh, të gjithë të specializuar në disiplinën e tyre. Stafi akademik organizohet në tre fakultete, ku secili prej të tyre ndahet të paktën në tre departamente dhe përmbush kërkesat e përcaktuara për masën kritike dhe kualifikimet. **[18.0; 19.0]** Universiteti ka një faqe publike në internet, që përmban një gamë të gjerë informacionesh, disa prej të cilave mundësohen edhe në gjuhën angleze. [\[www.umed.edu.al\]](http://www.umed.edu.al) **[Kapitulli, III, Standardi II.1]**
- 1.15 Bordet drejtuese, si Senati, Bordi i Administrimit dhe Këshilli i Etikës, veprojnë aktualisht brenda Universitetit në nivel institucional. Këshillat e mëparshëm të Fakultetit dhe të Profesorëve, kanë vepruar në nivel fakulteti. Pas hyrjes në fuqi të ligjit nr. 80/2015, puna e bordeve të sipërpërmendur i ka kaluar zyrës së Dekanit, dhe këto të fundit janë pezulluar, në pritje të përfundimit të riorganizimit. Si stafi, ashtu edhe studentët pohojnë se ka mundësi të shumta për të ngritur çështje të ndryshme, për t'u angazhuar në debat dhe për t'u informuar për punën e këtyre bordeve drejtues dhe vendimmarrjes së tyre. **[M3a; M3b; M4; M5; M7; M9]** Për stafin, si atë akademik ashtu edhe atë profesional, çështjet dhe vendimet ndjekin një qasje nga lart, ose nga poshtë, nëpërmjet mbledhjeve të hapura, të shpeshta, të organizuara nga departamentet dhe

zyra e dekanit ose drejtoritë. Studentët mund të ngrenë çështje nëpërmjet Këshillit Studentor dhe përfaqësuesve të tyre të zgjedhur në Senat (shih pikat 4.9 dhe 5.9 më poshtë). **[Kapitulli, III, Standardi II.3]**

- 1.16 Universiteti ka një bashkëpunim të ngushtë me sektorin e shëndetësisë dhe me punëdhënësit e profesionistëve të shëndetësisë, i cili siguron njohuri për tendencat e kërkesës për mjekë, infermierë, dentistë dhe specialistë të tjerë. **[1.11.1]** Konferencat, veprimtaritë kërkimore dhe panairët e punës gjithashtu, kontribuojnë në informacion rreth kërkesës për profesione dhe aftësi të nevojshme, si në Shqipëri ashtu edhe jashtë vendit. **[11.2]** Është nënshkruar një marrëveshje me një agjenci gjermane, lider në punësim, për t'u ofruar studentëve trajnime të zgjeruara, me qëllim ofrimin e më shumë lehtësirave atyre që dëshirojnë të punojnë jashtë vendit. **[37.5]**
- 1.17 Në Universitetin e Mjekësisë Tiranë, studentët regjistrohen me qëllim ndjekjen e karrierës në fushën e mjekësisë dhe në profesione të lidhura me shëndetësinë dhe ndjekjen e studimeve më të thelluara në ciklet e dyta dhe të treta. Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe organe të tjera rregullatore, kërkojnë të dhëna për performancën e të diplomuarve të universitetit, në provimet e profesioneve të rregulluara në fushën e mjekësisë. **[37.4; 37.6; 37.7]** Universiteti grumbullon njohuri të konsiderueshme për karrierat e ardhshme të diplomuarve të tij, nëpërmjet rrjetëzimit dhe ndërveprimit me sektorin e shëndetësisë. Të dhënat mbledhen kryesisht në nivel fakulteti dhe departamenti, dhe në lidhje me profesionistë të shëndetësisë, për të cilët ofrohen trajnime. **[AE8]** Janë realizuar anketime për alumni, për të shqyrtuar përshtatshmërinë e programeve me praktikën. **[1]** Megjithatë, universiteti e ka evidentuar situatën e ndërlikuar dhe shtrirjen gjeografike të karrierave të të diplomuarve të tij dhe është i vetëdijshëm ndaj sfidave që këto mund të përbëjnë në të ardhmen për mbledhjen dhe analizën e të dhënave rreth punësimit të të diplomuarve (Shihni pikën 5.12). **[M5; FE3.5]**
- 1.18 Universiteti synon të jetë konkurrues për sa i përket stafit, studentëve dhe burimeve. Ai ka vendosur kritere transparente dhe meritokratike të përzgjedhjes dhe rekrutimit, të cilat i publikon së bashku me informacionit për programet dhe tarifatat e shkollimit në faqen e tij të internetit. **[Kapitulli, III, Standardi III.1]**
- 1.19 Universiteti hyn në marrëveshje bashkëpunimi dhe partneriteti, për të përmirësuar cilësinë dhe Standardet e shërbimeve të tij, me anë të mobilitetit, veprimtarisë së përbashkët kërkimore dhe njohjes me praktikën më të mira ndërkombëtare në fushën e mjekësisë. **[22; 23]** Strategjia e universitetit e përcakton ndërkombëtarizimin si një prioritet, duke përfshirë planet për marrëveshje të tjera ndërinstitucionale të mobilitetit, më shumë projekte të përbashkëta kërkimore, dhe zhvillimin e programeve të përbashkëta në anglisht. **[2.2]**
- 1.20 Universiteti ka nënshkruar një sërë marrëveshjesh me institucione të arsimit të lartë, institucione të kujdesit shëndetësor, dhe një numër të madh marrëveshjesh me organizata të tjera publike dhe private, si nga Shqipëria, ashtu edhe nga vende të tjera. **[21; 21.1; 21.2]** Marrëveshjet e shkëmbimit janë si për stafin akademik dhe profesional, ashtu edhe për studentët. Universiteti bashkëpunon, gjithashtu, me universitete dhe spitale në vende shqipfolëse, si Kosova dhe Maqedonia, duke përfshirë njohjen e stafit dhe pranimin e numrit të përcaktuar të studentëve. **[Kapitulli, III, Standardi III.2]**
- 1.21 Universiteti, në përputhje me ligjin nr. 80/2015, është pjesë e sistemit universitar të shëndetësisë në Shqipëri. Departamentet e universitetit kanë funksione klinike, mësimdhënëse dhe kërkimore. **[18.1]** Universiteti bashkëpunon me gjashtë spitale publike dhe klinika, me shërbimin e transfuzionit të gjakut, me Institutin e Shëndetit

Publik, me qendrat e kujdesit parësor shëndetësor dhe strukturat private, siç janë farmacitë.

1.22 Grupi i Vlerësimit të Jashtëm e identifikoi bashkëpunimin e ngushtë dhe të efektshëm, që universiteti ka krijuar me sektorin e shëndetësisë, që mundëson ndjekjen e vazhdueshme të praktikës akademike dhe mjekësore, kërkimit dhe trajnimit, si një karakteristikë të **praktikës së mirë**. Këto lidhje rrisin cilësinë e përvojës së studentëve, nëpërmjet aksesit në infrastrukturën e shëndetësisë dhe kontakteve me profesionistët e shëndetit, nxisin hartimin dhe zhvillimin e programeve, rritin mundësitë e angazhimit në praktikë të studentëve, zhvillojnë kërkimin dhe ofrojnë mundësi për punësim. Marrëdhënia me sektorin e shëndetësisë vepron në disa nivele, në të gjitha fushat e universitetit, dhe është si konstruktive, ashtu edhe e dobishme, për të dyja palët. Falë këtij bashkëpunimi të ngushtë, universiteti është më i përgatitur për të përmbushur misionin e formimit të profesionistëve të shëndetit, që praktikojnë kujdesin optimal ndaj pacientit, me qëllim parandalimin dhe trajtimin e sëmundjeve dhe përparimin e kërkimit shkencor, në dobi të shëndetit. (Shihni pikat 2.12. 2.13. 3.11. 4.1). **[2.2] [Kapitulli, III Standardi III.3]**

1.23 Universiteti rekruton edhe një numër të konsiderueshëm studentësh nga pakicat joshqiptare nga vendet fqinj të Ballkanit. **[FE: Indeksi i dokumenteve të vëna në dispozicion]** Punësohet një numër i vogël anëtarësh joshqiptarë në stafin akademik, dhe pedagogë të tjerë ftohen për të mbajtur leksione dhe orë mësimore për studentët e shkëlqyer. Universiteti merr pjesë në projekte ndërkombëtare të financuara nga Bashkimi Evropian, si skema e Erasmus dhe Horizon 2020, që janë gjerësisht të publikuara për stafin dhe studentëve. **[23]** Pjesëmarrja në programe të tilla u evidentua në disa raste gjatë takimit të Grupi të Vlerësimit të Jashtëm me stafin dhe studentët. **[M7; M8a; M8b]** Studentët njoftohen për mundësitë e mobilitetit, dhe njihen kreditet që fitohen jashtë vendit. Studentët e rinj mirëprehen dhe përfitojnë veçanërisht nga modulet që zhvillohen në gjuhën angleze. Mundësitë në rritje për mobilitetin e stafit dhe studentëve, kërkimi i përbashkët dhe botimet ndërkombëtare, prurja në rritje e lektorëve ndërkombëtarë dhe folësve të ftuar, dhe zhvillimi i programeve të përbashkëta me partnerë jashtë vendit, janë të përcaktuara në Planin Strategjik të universitetit. **[0.2.2; M1][Kapitulli, III, Standardi III.4]**

Gjetje

Praktika e mirë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi karakteristikën e mëposhtme të praktikës së mirë.

- Marrëdhëniet e ngushta bashkëpunuese, të efektshme, që Universiteti ka zhvilluar me sektorin e shëndetësisë (pikat 1.22 dhe 4.1; **Kapitulli, III, Standardi III.3**)

Dobësi

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi asnjë dobësi.

Rekomandime

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk dha rekomandime.

Pohim i veprimeve të ndërmarra

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm pohoi se veprimet e mëposhtme po ndërmerren aktualisht:

- Puna që po ndërmerret për të përmbushur kërkesat e ligjit nr. 80/2015 (pika 1.1; **Kapitulli, III Standardi I.1**)
- Hapat e ndërmarra, për të forcuar cilësinë e vlerësimit dhe Standardet, nëpërmjet themelimit të Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (pikat 1.8 dhe 4.23; **Kapitulli, III, Standardi I.4**).

Gjykimi

Standardet për Organizimin dhe Menaxhimin e tij janë përmbushur plotësisht.

Fusha e Vlerësimit 2: Burimet

- 2.1 Universiteti ka një politikë të hapur për rekrutimin dhe emërimin e stafit akademik, administrativ dhe mbështetës, të bazuar në procedura sistematike. **[Nenet 64-79; 24; 24.1; 24.4; 42]** Universiteti, në fillim të çdo viti, përcakton nevojat për burime njerëzore si për stafin me kohë të plotë, ashtu edhe për stafin me kohë të pjesshme. Këto rishikohen nga Senati dhe nga Rektori, të miratuara nga Bordi i Administrimit, dhe bëhen publike si në faqen e internetit, ashtu edhe në faqen e internetit të Zyrës së Prokurimeve Publike. Kriteret e pranimit bazuar në mesataren e ponderuar, publikohen paraprakisht, dhe rezultatet e aplikantëve vlerësohen nga një komision i ngritur për këtë qëllim. Kriteret përfshijnë ponderime të favorshme për aplikantët nga universitete të njohura ndërkombëtarisht. Aplikantët informohen në lidhje me renditjen e tyre në këtë proces, dhe ata që renditen poshtë kanë mundësinë të ankohen. Universiteti e ka organigramën e tij të publikuar në faqen e internetit, së bashku me një sërë dokumentesh kyçe [\[http://umed.edu.al/universiteti/organigrama-umt/\]](http://umed.edu.al/universiteti/organigrama-umt/). **[Kapitulli, III, Standardi IV.1]**
- 2.2 Të gjithë stafit të ri akademik me kohë të plotë, i caktohet një mentor për mësimdhënien për vitin e tyre të parë të punës. Gjatë kësaj periudhe, ata duhet të ndjekin dhe të vëzhgojnë të gjitha orët mësimore të zhvilluara nga mentori i tyre, dhe nga ana tjetër, mentori i tyre vëzhgon të gjitha orët mësimore që zhvillon pedagogu i ri. **[M7]** Kjo i shërben orientimit personal në universitet dhe kërkesave për mësimdhënie. Stafi akademik dhe ai administrativ, nxiten të angazhohen në veprimtaritë sociale dhe kulturore dhe veprimtaritë e organizuara në interes të studentëve dhe komunitetit të gjerë. **[26.1. 26.2. 26.3]** Këto veprimtari dhe integrimi e orientimi i stafit të ri, janë mbështetur me informacion të shkruar për Universitetin, përfshirë një manual për studentët, një udhëzues për kampusin dhe historikun e Arsimit të Lartë në Mjekësi, në Shqipëri. **[27.1; 27.3; 27.4; 27.5]** **[Kapitulli, III, Standardi IV.2]**
- 2.3 Universiteti e vlerëson stafin e tij, të paktën një herë në vit, nëpërmjet një sërë mekanizmash, që përfshijnë: kryerjen e ngarkesës mësimore; efektshmërinë e zhvillimit të programeve (mbajtja në universitet dhe arritjet e studentëve); analizën e feedback-ut nga studentët; vlerësimin e veprimtarisë kërkimore dhe administrimin e efektshëm. Vlerësimet e stafit kryen nga Përgjegjësi i Departamentit dhe i raportohen Dekanit të Fakultetit. Dokumentet në fjalë po mblidhen në mënyrë sistematike nga Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. **[RVV fq.19; 1.0 Neni 27; 3.0 Neni 24; 17.0; 37.3; FE13]** Stafi akademik u shpreh se zhvillimi profesional përbën prioritet; megjithatë, ai është i lidhur më tepër me fushën e praktikës profesionale, se sa me të nxënit dhe mësimdhënien. **[M7]** Universiteti angazhohet aktivisht në promovimin dhe ndërkombëtarizimin e axhendës dhe ka nënshkruar një sërë marrëveshjesh me universitete nga jashtë vendit. **[21.2]** Universiteti merr pjesë në një mori aktivitete ndërkombëtare bashkëpunuese, që i ofrojnë stafit mundësinë për të punuar me/në universitete ndërkombëtare. **[16; 23]** Kriteret e universitetit për marrjen e gradës “profesor”, kërkon kandidatë që kanë dhënë mësim, ose kanë zhvilluar kërkim në një universitet ndërkombëtar, dhe procedurat për këtë kërkojnë angazhimin e një profesori të huaj në Komisionin e Vlerësimit për titujt akademikë. **[4; 4.1; 5.0]** **[Kapitulli, III, Standardi IV.3]**
- 2.4 Një sërë aktivitete sociale, kulturore dhe komunitare, organizohen nga stafi i Universitetit dhe nga studentët, me ndihmën e Këshillit Studentor. Ato përfshijnë festimet e festave zyrtare, festivaleve kulturore, përvjetorëve, ceremonitë e diplomimit, promovime librash dhe aktivitete sportive. Në veçanti, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm vuri re numrin e aktiviteteve që studentët kanë organizuar në komunitetin e gjerë, për të mbështetur grupet e pafavorizuara, ose për të rritur ndërgjegjësimin ndaj çështjeve shëndetësore dhe sociale, dhe nëpërmjet tyre të promovojë dialogun social. **[26.2; M8]** Universiteti paguan sigurimet shëndetësore dhe ato shoqërore të stafit të tij. **[M9]** **[Kapitulli, III, Standardi IV.4]**

- 2.5 Menaxhimi i efektshëm i burimeve njerëzore mbështetet nga përcaktimet e qarta të detyrimeve, të drejtave, përgjegjësi dhe roleve kontraktuale, për çdo punonjës, për sa i përket punësimit dhe përshkrimit të pozicionit të punës. **[3 Kap. 2; 3.1; 24.3]** Ngarkesa e punës dhe performanca, rishikohen në bazë vjetore, duke ofruar mundësi për përshtatje në kushtet e punësimit, siç janë orët e punës dhe mbulimi i lëndës. Kontratat e punësimit arkivohen nga Departamenti i Burimeve Njerëzore, i cili mbikëqyr ruajtjen dhe përdorimin e tyre. **[24.4] [Kapitulli, III, Standardi II.2]**
- 2.6 Universiteti përdor një model buxheti afatmesëm, që zgjat për një periudhë tre-vjeçare dhe që rishikohet dhe ndryshohet në bazë vjetore. **[1.0 Neni 88]** Ky model i ofron më shumë qëndrueshmëri në parashikimin e të ardhurave dhe shpenzimeve. Fondet e përcaktuara nga buxheti i shtetit, si edhe të ardhurat që ka krijuar universiteti, nga shërbimet dhe nga veprimtaritë fitimprurëse, administrohen në përputhje me rregulloret statutoare. Buxheti ndjek një qasje me drejtim poshtë-lartë me propozimet nga departamentet dhe njësitë administrative, nga fakultetet te Rektorati. Buxheti sistemohet së bashku me argumentet mbështetëse të Zyrës së Buxhetit dhe Investimeve të universitetit dhe i dërgohet Senatit Akademik, nga Kancelari i universitetit, për t'u shqyrtuar dhe miratuar. Menjëherë pas miratimit nga Senati, buxheti i kalon Bordit të Administrimit, i cili e shqyrton në bazë të kriterëve të efikasitetit dhe dobisë. **[10]** Pasi miratohet nga Bordi, buxheti i detajuar kthehet në nivel fakulteti dhe departamenti, për t'u zbatuar. Në të ardhmen, universiteti planifikon t'iu japë më shumë autonomi fakulteteve për hartimin e buxhetit. **[M4] [Kapitulli, III, Standardi VI.1]**
- 2.7 Përgjegjësitë e drejtuesve të lartë brenda universitetit, përcaktohen qartësisht në Statut dhe rregulloret e universitetit **[1.0. Neni 3]**, ashtu si edhe rolet e njëjësive të themeluara për të ndihmuar me përgatitjen dhe zbatimin e buxhetit: Zyra e Buxhetit dhe Investimeve dhe Njësia e Auditimit, që janë gjithashtu përgjegjëse për të siguruar se procesi i buxhetit i përmbahet rregullave të kontabilitetit dhe legjisllacionit shqiptar. **[10]** Mbikëqyrja e kryer nga Senati Akademik dhe Bordi i Administrimit, siguron transparencën. Gjatë shqyrtimit, Senati Akademik e përmend buxhetin në misionin e universitetit, zhvillimit të politikave dhe në planin strategjik. **[10.3] [Kapitulli, III, Standardi VI.2]**
- 2.8 Universiteti, në përputhje me ligjin nr. 114/2015, kryen një proces të hollësishëm të auditit të brendshëm. **[10]** Kjo rezulton në një raport dhe një plan veprimi analitik dhe autokritik **[10.1]**, që i vihen në dispozicion Rektorit, të diskutuar në mbledhjet e stafit dhe shpërndarë fakulteteve dhe departamenteve, për zbatim **[10.2]** Universiteti i nënshtrohet auditit të jashtëm nga Ministria e Arsimit dhe Sportit, nga Zyra Vendore e Taksave, Kontrolli i Lartë i Shtetit dhe Ministria e Financave. **[RVV fq.22]** Udhëzimet, në raportet e fundit të auditit nga Ministria e Arsimit dhe Sportit, kanë sjellë përmirësime në formalizimin e qasjes sistematike ndaj burimeve dhe kryerjes së auditit të brendshëm. Raporti i adutit të jashtëm publikohet dhe iu vihet në dispozicion të gjithë stafit dhe studentëve. **[Kapitulli, III, Standardi VI.3]**
- 2.9 Sistemi i menaxhimit të informacionit të universitetit është i efektshëm në mbështetjen e punës së stafit, studentëve dhe administratës. Universiteti është pjesë e Rrjetit Akademik Shqiptar (RASH), i cili i mundëson atij akses në funksione, nëpërmjet ESSE3 IRIS për nevojat mësimore, kërkimore dhe administrative. Përmes këtij sistemi, të dhënat e Universitetit përcillen në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit. Universiteti, gjithashtu ka një marrëdhënie me Agjencinë Kombëtare të Provimeve në Shqipëri, nëpërmjet këtij sistemi që i mundëson atij të nxjerrë të dhënat e aplikantëve. Universiteti përdor edhe sistemin e menaxhimit elektronik të APAAL-it, me anë të të cilit menaxhon informacionin aktual dhe arkivor, rreth programeve të studimit, studentëve dhe stafit. **[RVV fq.23; 45.2; 45.8]** Sektori i TI-së, i Drejtorisë së Shërbimeve të Përgjithshme të Universitetit, mbështet dhe koordinon strukturat e TI-së, të cilat përveç strukturave për stafin akademik dhe

administrativ, përfshijnë gjashtë laboratorë kompjuterikë, që kanë gjithsej 176 kompjuterë, duke siguruar një raport të favorshëm midis studentëve dhe kompjuterëve, përkatësisht në raportin 10:1. Anketimi i APAAL-it për studentët, tregoi një nivel relativisht të lartë të pakënaqësisë për cilësinë e aksesit në kompjuterë dhe aksesin në internet. Megjithatë, kjo nuk u evidentua në takimet që Grupi i Vlerësimit të Jashtëm zhvilloi me studentët, gjatë vizitës. **[M3a; M3b; M8a; M8b]** Universiteti publikon të gjitha informacionet kryesore rregullatore dhe akademike, në faqen e tij të internetit, duke përfshirë të dhënat për prurjen e studentëve. **[SED fq.23; 45.3; 45.4; 45.9]** Universiteti përfiton edhe nga shoqërimi i tij me spitalet në Tiranë, për sa i përket qasjes në strukturat profesionale të TI-së dhe bazat e të dhënave si Telemjekësia. **[25.3] [Kapitulli, III, Standardi VII.1; Kapitulli, III, Standardi VII.2]**

2.10 Universiteti ka mekanizma dhe infrastrukturë të përshtatshme, për administrimin e aseteve të tij. Ai mban një regjistër të pasurive të paluajtshme të tij **[27.4; 28; 28.1; 28.2]** Plani Strategjik 2017-2020, parashikon një kontekst gjithëpërfshirës për zhvillimin e Universitetit, por është mjaft i gjerë në qasjen e tij. **[2.2]** Përgjegjësia operationale për pasurinë e paluajtshme i përket Drejtorisë të Buxhetit dhe Investimeve, që monitoron dhe përpilon inventarët e pasurive të universitetit dhe zbaton planet e mirëmbajtjes dhe zgjerimit, në përputhje me buxhetin e miratuar, nën kujdesin e Kancelarit dhe Bordit të Administrimit. **[RVV fq.25] [Kapitulli, III, Standardet VII.3; Kapitulli, III Standardi VII.5]**

2.11 Universiteti ka politika dhe burime për të mbledhur, ruajtur, mbrojtur dhe zhvilluar trashëgiminë kulturore dhe shkencore. Biblioteka është përgjegjëse për katalogimin e teksteve shkencore dhe kulturore të universitetit, duke mbrojtur botimet në format të shtypur dhe duke i digjitalizuar ato, për të krijuar një burim historik të përhershëm dhe të aksesueshëm. **[RVV fq.26. M9]** Këshilli Botues i Universitetit mundëson botimet cilësore, në revistën shkencore, të botuar nga universiteti **[3.0 Nenet 19. 6. 6.1. 39]** duke ofruar një strukturë dhe mundësi për stafin. **[Kapitulli, III, Standardi VII.4]**

2.12 Universiteti ofron shërbime bazë të interesit të përbashkët, në nivel makro dhe mikro, për komunitetin vendor e më gjerë, nëpërmjet: ofrimit të shërbimeve mjekësore në Shërbimin Shëndetësor të Shqipërisë; kontributit të tij në kërkimin mjekësor; ofrimit të shërbimeve të diagnostikimit; parandalimit dhe ekzaminimit; dhe aktiviteteve të tij me anë të stafit dhe studentëve për rritjen e ndërgjegjësimit ndaj çështjeve sociale dhe çështjeve të shëndetit publik. Studentët e universitetit gjithashtu kryejnë një sërë aktiviteteve, lidhur me mbështetjen e komunitetit, siç janë vizitat në jetimoren e fëmijëve. **[1; 2.2;;2.2 ; M6; 26.1;26.3] [Kapitulli, III, Standardi VII.6]**

2.13 Universiteti ofron pajisje dhe infrastrukturë të përshtatshme për veprimtarinë akademike dhe kërkimore. Universiteti zotëron ndërtesat dhe strukturat e veta, dhe ndodhet në afërsi të Spitalit Universitar Nënë Tereza dhe strukturave të qendrave shëndetësore, me të cilat është i lidhur në mënyrë të pandashme. Kjo siguron një gamë të përsosur dhe të pasur të burimeve, për stafin dhe studentët **[RVV fq.28; 1.0. 3.0; M1; M6]** Ambientet e Universitetit përfshijnë një numër të përshtatshëm të auditorëve të leksioneve, zyra akademike dhe administrative, laboratorëve, klasave të seminareve, laboratorë të TI-së dhe bibliotekë **[RVV fq.28-29; Vizitë në terren]**

2.14 Të gjitha ndërtesat e Universitetit janë ndërtuar me materiale bashkëkohore, me ndriçim të mjaftueshëm dhe me lartësi jo më pak se 3.0 m në ambientet e mësimdhënies. Ato përmbushin Standardet higjienike dhe sanitare, izolimin e zhurmës dhe rregullimin e temperaturës, kërkesat e sigurisë dhe të sigurisë nga zjarri, dhe gjenden në një zonë të Tiranës mjaft larg nga zonat industriale. **[29; 30]** Laboratorët, mjediset e mësimdhënies dhe burimet e bibliotekës, u konsideruan të mjaftueshme për Grupin e Vlerësimit, për të përmbushur nevojat e studentëve dhe stafit të universitetit, sidomos për sa i përket

aksesit të universitetit në strukturat e spitalit. Evidentohet vendosmëria e universitetit për të përmirësuar më tej këto struktura..[RVV fq.30][*Kapitulli, III, Standardi V.1*]

2.15 Universiteti disponon dokumentacionin e plotë të veprimtarisë akademike në format të shtypur dhe elektronik, nga ku merr informacione strategjike dhe të dhëna statistikore. Kjo garantohet nga Sektori i Arkiv-Protokollit të Drejtorisë së Shërbimeve të Përgjithshme, që vepron në përputhje me ligjin për arkivat nr. 9154. Arkëtimi dhe arkivimi i aktivitetit, përfshijnë dosjen e plotë të studentëve, kontratat e stafit dhe informacion për programet. Faqja e internetit të universitetit përfshin raporte kyçe që përmbajnë të dhënat e mbledhura. [RVV fq.29; 24.4; 31; 42; 45.2-3] [*Kapitulli, III, Standardi V.2*]

Gjetje

Praktika e mirë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi karakteristika të praktikës së mirë.

Dobësi

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi asnjë dobësi.

Rekomandime

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk dha rekomandime.

Pohimi i veprimeve të ndërmarra

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk pohoi asnjë veprim të ndërmarrë.

Gjykimi

Standardet për Burimet janë përmbushur plotësisht.

Fusha e Vlerësimit 3: Kurrikula

- 3.1 Misioni i Universitetit është t'i formojë studentët në fushat e shkencave mjekësore, në të tria ciklet e studimit, sipas Standardeve më të larta profesionale; të përgatisë profesionistë që janë të aftë të ofrojnë kujdes optimal ndaj pacientëve; të parandalojë dhe të trajtojë sëmundjet; dhe të përparojë me kërkimin shkencor. **[RVV fq. 30; 1.0]** Universiteti, në përputhje me misionin e tij, ofron programe për të tre ciklet e studimit. **[UMT-Profilin i institucionit: 33; FE4.5]** Informacioni rreth programeve të studimit të ofruara, publikohet nëpërmjet faqes së tij të internetit, [\[http://umed.edu.al/?lang=en\]](http://umed.edu.al/?lang=en) fletëpalosjeve informuese, **[27.3]** kontakteve me shkollat e mesme dhe në panairët e punës. **[M5]** Një burim tjetër informacionesh është portali i studentëve, i cili përmban të dhëna për aplikantin, si edhe një forum online ku të interesuarit mund të bëjnë pyetje. **[M2;M5] [Kapitulli, I, Standardi I.1]**
- 3.2 Universiteti ofron module të edukimit në vazhdim për të gjitha fushat e studimit, në mënyrë që profesionistët të jenë gjithmonë të përditësuar, **[RVV fq.32; 25.2;M2]** dhe ka nënshkruar një Memorandum Mirëkuptimi me Spitalin Universitar Nënë Tereza për realizimin e edukimit në vazhdim, **[25.2;M2]** si edhe bashkëpunon ngushtësisht me organe profesionale. Veprimtaria e universiteti për edukimin në vazhdim është e akredituar nga Qendra Kombëtare e Edukimit në Vazhdim (QKEV). Universiteti i vë në dispozicion QKEV-së, ekspertizën e tij për vlerësimin e aktiviteteve trajnuese, si pjesë e kontributit të tij për të nxënësit gjatë gjithë jetës dhe edukimit të stafit mjekësor të spitaleve dhe klinikave. **[RVV fq.33; 25.2.1]** Edukimi në vazhdim konsiderohet si një burim i rëndësishëm të ardhurash për universitetin. **[M4] [Kapitulli, I, Standardi I.2]**
- 3.3 Plani Strategjik 2017-2020, përcakton si synim kryesor përgatitjen e studentëve si në planin teorik, ashtu edhe në planin praktik. **[2.2]** Rregulloret në lidhje me lëshimin e diplomave, janë qartësisht të përcaktuara. **[3.0. Nenet 55-59]** Detajet e programeve të studimit përmbajnë informacione për diplomat e lëshuara, në përfundim të studimeve të tyre. **[35.1; 35.2; 35.3]** Diplomat shoqërohen me një Supplement të diplomës dhe ndjekin kërkesat e Standardeve evropiane. **[FE3.1] [Kapitulli, I, Standardi I.3]**
- 3.4 Nga vetë natyra e tyre, programet e studimit të universitetit në mjekësi, stomatologji dhe shëndetësi, i përgatisin studentët për punësim. Një tipar i rëndësishëm është integrimi i teorisë me studimet klinike, shkencore dhe profesionale. **[20.2; 20.3]** Aktualisht, nuk ka diploma të përbashkëta, megjithëse po diskutohet për një diplomë të tillë për nivelin Master. **[M5]** Ftohen lektorë të huaj për të mbajtur leksione për kurset që ofron universiteti. **[38.1]** Si pjesë e marrëveshjeve bashkëpunuese, shumë prej pjesëtareve të stafit akademik të universitetit kanë stasusin e stafit akademik në universitete dhe qendrat spitalore në rajon. **[RVV fq.15] [Kapitulli, I, Standardi I.4]**
- 3.5 Universiteti ka një model planifikimi të ngarkesë së punës për stafin akademik, ku ngarkesa mësimore e pedagogëve caktohet në përputhje me aktet nënligjore në fuqi. **[42.0]** Ngarkesa shtesë mësimore mbështetet nga burimet e veta të universitetit. **[RVV fq.34]** Programet e studimit në përputhje me kapacitetet akademike dhe infrastrukurore. **[RVV fq.34]** Për rritjen e numrit të studentëve, universiteti kryen një analizë financiare të burimeve të tij, me qëllim punësimin e stafit të ri. **[M1]** Veprimtaritë ku përfshihet stafi akademik janë: mësimdhënia (50-70 për qind e ngarkesës vjetore); kërkimi dhe zhvillimi (20-30 për qind e ngarkesës vjetore); dhe ofrimi i mbështetjes ndaj institucionit (10-20 për qind e ngarkesës vjetore). **[RVV fq.34. FE1.2] [Kapitulli, I, Standardi I.5]**
- 3.6 Programet e studimit dhe objektivat e tyre, përcaktohen qartësisht. **[35.1; 35.2]** Në faqet e internetit të fakulteteve publikohen informacione në lidhje me programet e studimit. [\[http://umed.edu.al/university-event/fakultetet/fakulteti-i-mjekesise-dentare/programet-e-studimit/\]](http://umed.edu.al/university-event/fakultetet/fakulteti-i-mjekesise-dentare/programet-e-studimit/) Informacione mund të gjenden edhe në portalin U-

Albania, [<http://ualbania.arsimi.gov.al>], ku universiteti ka hapësirën e vet. Aty mund të gjenden informacione në lidhje me kriteret e pranimit, si edhe një forum ku aplikantët mund të marrin përgjigje në kohë reale për pyetje e tyre. **[RVV fq.32;M5]** Megjithatë informacionet ofrohen vetëm në gjuhën shqipe dhe nuk ofrohen informacione të detajuara mbi syllabuset. Kriteret e pranimit të studentëve përcaktohen nga departamentet **[14.0]** dhe miratohen nga Senati, **[14.1]** përpara se të shpallen në faqen e internetit të universitetit dhe në portalin U-Albania.

[<http://ualbania.arsimi.gov.al/DeGES/ProgramDetails/37>] Departamenti dhe fakultetet propozojnë kuotat e pranimit, duke marrë parasysh kapacitetin, **[14.0]** dhe më pas ato miratohen nga Senati, përpara se të dorëzohen në Ministrinë e Arsimit për miratim përfundimtar. **[Kapitulli, I, Standardi I.6]**

- 3.7 Studentët që takoi Grupi i Vlerësimit të Jashtëm, pohuan se ishin të qartë në lidhje me kriteret e pranimit, përmbajtjen e programit dhe objektivat e të nxënit. **[M3a; M3b; M8a]** Universiteti ka synim të garantojë cilësi të lartë për studentët e pranuar, duke vendosur si një kriter pranimi notën mesatare mbi 8/10 për ciklin e parë të programeve të studimit dhe notën mesatare mbi 8.5/10 për ciklin e dytë të programeve të integruara të studimit të Masterit të Shkencave. **[16.0]** Universiteti iu ofron studentëve, në vitet e ndërmjetme, mundësinë e transferimit në programe të ngjashme të të njëjtit cikël, nga institucione të ndryshme të arsimit të lartë. Në fillim të vitit akademik, universiteti vendos kuotat e lejuara për transferimin. **[3.0;M5]** Studentët e ciklit të parë vihen në dijeni gjatë dhe në fund të studimeve të tyre, në lidhje me mundësitë e punësimit që i përshtatet diplomës së tyre. **[M3b]** Përgjithësisht, studentët preferojnë të vazhdojnë studimet e ciklit të dytë, por mund të gjejnë punësim në përfundim të ciklit të parë, ndërkohë që kanë marrë një licencë për ushtrimin e profesionit. **[M5]** Një numër i konsiderueshëm studentësh punësohen jashtë vendit, në veçanti studentët me diplomë të nivelit të parë në infermieri. **[M6;M3b]** Universiteti nuk ka të dhëna sistematike për të punësuarit në fund të ciklit të parë të studimeve. **[M5] [Kapitulli, I, Standardi I.7]**
- 3.8 Studentët që takoi Grupi i Vlerësimit të Jashtëm, u shprehën pozitivisht rreth orientimit për universitetin dhe për informacionet e ofruara për kurrikulën. **[RVV f.51; M3b]** Metodrat e mësimdhënies në ciklin e parë, pasqyrojnë një ekuilibër midis teorisë dhe përvojës praktike, duke u mbështetur si në stafin e Spitalit Universitar, ashtu edhe në stafin e universitetit. Rekrutimi i stafit të ri akademik në universitet, bazohet në kritere që u japin përparësi jo vetëm përvojës së mësimdhënies, por edhe angazhimit të tyre në kërkime shkencore. **[RVV fq.36; M4]** Më shumë se 85% e stafit akademik me kohë të plotë, zotëron të paktën gradën shkencore PhD, ndërsa 58 për qind të tjerë kanë titullin Profesor ose Profesor i Asociuar. **(FE4.5)** Përfshirja e ngushtë e punonjësve të Spitalit Universitar në mësimdhënie, duke mbuluar proceset para-klinike dhe klinike, i mundëson secilit student që të plotësojë nevojat e tij të të mësuarit, veçanërisht në përvetësimin e aftësive praktike **[RVV fq.36; M5; M3b] [Kapitulli, I, Standardi I.8]**
- 3.9 Universiteti ofron 17 programe studimi të ciklit të dytë: shtatë programe Master të Shkencave, shtatë programe Master Profesional dhe tri programe të integruara Master të Shkencave. **[FE4.5]** Mbi 70 për qind të stafit akademik të punësuar me kohë të plotë në universitet, janë të angazhuar në programet e ciklit të dytë **[AE12]** Studimet e ciklit të dytë promovojnë zgjerimin e njohurive dhe kërkimeve të pavarura, dhe studentët e kanë të detyrueshme shkrimin e një teze diplome për këto programe. **[35.1; 35.2]** Studentët e Masterit të Shkencave dhe të specializimit afatgjatë, marrin pjesë në kërkime dhe paraqesin punimet e tyre shkencore në konferencat vjetore të organizuara nga universiteti. **[26.1; M8a]** Programi i ciklit të dytë të Masterit të Shkencave dhe programet e integruar të ciklit të dytë të Masterit të Shkencave, hartohen në përputhje me politikën e kërkimit shkencor dhe profesional të universitetit. **(RVV fq.37)** Praktika profesionale dhe klinike e studentëve është një element i rëndësishëm i këtyre programeve studimore dhe zhvillohet në bashkëpunim me njësitë e Spitalit Universitar dhe shërbime

të tjera publike ose private të sektorit të shëndetësisë. **[RVV fq.37]** Stafi i Spitalit Universitar është i përfshirë në mësimdhënien në programet e ciklit të dytë dhe vepron si mbikëqyrës i tezave të diplomave dhe praktikës profesionale. **[M5]** Universiteti është në gjendje të mbledhë disa të dhëna statistikore lidhur me punësimin e të diplomuarve nga organet profesionale dhe nga Ministria e Shëndetësisë, **[RVV fq.52; 37.6; 37.7]** por kjo praktikë nuk është e përgjithësuar (shih gjithashtu pikën 5.12). **[Kapitulli, I, Standardi I.9]**

- 3.10 Programet e studimit të universitetit janë organizuar në tre cikle të njëpasnjëshme, në përputhje me Procesin e Bolonjës. **[RVV f.37; 1.0]** Programet e studimeve të ofruara organizohen në module dhe vlerësohen me kredite, sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Akumulimit të Krediteve (ECTS) **[3.0; 35.1; 35.2; 35.3]** Në përputhje me kriteret e vendosura nga Senati, studentët e Masterit të Shkencave dhe doktoraturës duhet të kenë aftësinë për të komunikuar në një gjuhë të huaj, bazuar në testet ndërkombëtare të pranuar (niveli B2 për nivelin master). **[AE3; 1.0]** Ka disa raste të suksesshme të mobilitetit të studentëve në universitetet partnere evropiane, **[AE9; M8a]** por mobiliteti i studentëve është aktualisht i ulët. **[AE9]** Universiteti u ofron studentëve në vitet e ndërmjetme mundësinë për transferimin e studimeve në programe të ngjashme të ciklit të njëjtë në institucione të ndryshme të arsimit të lartë. **[1.0; 32.1]** Universiteti i njeherë kreditet e fituara në institucione të tjera si në vend, ashtu edhe jashtë tij, në përputhje me rregullat e tij. **[1.0;3.0] [Kapitulli, I, Standardi I.10]**
- 3.11 Një pikë e fortë e rëndësishme e organizimit të programeve të studimit në universitet është mënyra se si ndahen burimet (njerëzore dhe fizike) me Spitalin Universitar. **[28.0; 28.1;M6]** Numri i krediteve të akorduara për çdo aktivitet mësimor, siç janë puna laboratorike, detyrat dhe projektet, praktika profesionale dhe teza përfundimtare, janë në përputhje me objektivat e programit **[35.1; 35.2; 35.3]** Kurrikula përditësohet vazhdimisht, me anë të rishikimeve vjetore, për të siguruar integritetin e zhvillimeve më të fundit në fushën e mjekësisë. **[34.0;M7]** Praktika profesionale zhvillohet nëpërmjet rrjeteve të shërbimit publik dhe privat të kujdesit shëndetësor, nën drejtimin e një profesori mbikëqyrës të caktuar nga universiteti, dhe studentët vlerësohen sipas krediteve përkatëse. **[RVV fq.38; 20.0]** Në programet e studimit të ciklit të parë, diploma vlerësohet nëpërmjet një provimi përfundimtar (teza e diplomës parashikohet vetëm për studentët e shkëlqyer), **[M4]** ndërsa për ciklin e dytë studentët duhet të dorëzojnë një tezë origjinale të diplomës, mbi një temë të miratuar nga departamenti. **[RVV fq.38]** Universiteti mbështet pjesëmarrjen e studentëve të Masterit të Shkencave në kërkime, si pjesë e programit të tyre të studimit. Organizohen konferenca vjetore, ku studentët, të udhëhequr nga profesorët e tyre, paraqesin rezultatet e tyre kërkimore. **[M8a; FE3.4] [Kapitulli, I, Standardi I.11]**
- 3.12 Programet e studimit integrojnë aftësitë teorike me praktikën profesionale, **[35.1; 35.2]** dhe studentët janë të aftë të zhvillojnë aftësitë e tyre klinike brenda strukturave shëndetësore të universitetit, ose në kuadër të marrëveshjeve me institucionet e tjera **[RVV fq.39; 20.2; 20.3]** Studentët janë të mirëpërgatitur për punësimin. Përpyekjet e vazhdueshme për të hapur programe ndërdisiplinore të studimit pasqyrojnë synimin e universitetit për t'i ofruar tregut të punës të diplomuarit me njohuri dhe aftësi të zgjeruara. **[M5; 21.3] [Kapitulli, I, Standardi I.12]**

Gjetje

Praktika e mirë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi karakteristika të praktikës së mirë.

Dobësi

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi asnjë dobësi.

Rekomandime

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk dha rekomandime.

Pohim i veprimeve të ndërmarra

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk pohoi asnjë veprim të ndërmarrë.

Gjykimi

Standardet për Kurrikulën janë përmbushur plotësisht.

Fusha e Vlerësimit 4: Mësimdhënia, Mësimnxënia, Vlerësimi dhe Kërkimi

- 4.1 Siç i takon mjekësisë dhe lëndëve të lidhura me mjekësinë, universiteti ka një lidhje shumë të fortë me praktikën profesionale, nëpërmjet strukturave klinike, siç janë spitalet, në pronësi të organizatave të tjera. Janë nënshkruar marrëveshje zyrtare që mbulojnë këto marrëdhënie **[20.2; 20.3]** dhe një pjesë e madhe e mësimdhënies zhvillohet në bashkëpunim me këto organe të jashtëm, në mënyrë që shumë punonjës kanë punësim të dyfishtë, si në Universitet, ashtu edhe në praktikën klinike. Universiteti i menaxhon mirë këto marrëdhënie të nevojshme dhe studentët përfitojnë nga kontaktet me pedagogë me përvojë dhe ekspertë të praktikës klinike. Këto marrëdhënie bashkëpunimi të ngushta dhe të efektshme me sektorin e shëndetësisë, janë identifikuar si karakteristikë e **praktikës së mirë** në pikën 1.22
- 4.2 Kurrikulat në nivel programi, zhvillohen nga njësitë e duhura akademike dhe miratohen çdo vit nga Këshillat e Fakultetit dhe Senati Akademik, siç përcaktohet në rregullore **[3.0 Neni 36]** Kurrikulat në nivel kursi, zhvillohen paralelisht dhe në përputhje me kurrikulat në nivel programi, dhe janë miratuar në nivelin e njësisë akademike (Departamenti). Më pas vijon planifikimi i ngarkesës së punës, duke përfshirë një analizë të stafit të nevojshëm me kohë të pjesshme, që miratohet nga zyra përkatëse e dekanit. **[RVV fq.40]**
- 4.3 Gjatë zhvillimit të programeve, një grup auditimi kontrollon efektshmërinë e tyre; ai kryen kontrole të rastësishme për veprimtarinë, i vihet në dispozicion dokumentacioni faktik dhe zhvillon intervista me anëtarë të stafit. **[AE4.4]** Rezultatet e kontrollit paraqiten në një raport që përmban rekomandime për të përmirësuar cilësinë. **[AE4.4]**
- 4.4 Studentët, përgjithësisht, janë të kënaqur me organizimin e programeve të studimit, metodat e përdorura nga pedagogët e tyre, cilësinë e pedagogëve **[AE13.0]** dhe materialet studimore të ofruara. **[M3a; M3b]** **[Kapitulli, I Standardi II.1]**
- 4.5 Siç është theksuar në pikën 3.3 më lart, universiteti i pajis me një diplomë zyrtare studentët që i kanë përbushur të gjitha detyrimet e një programi studimi. **[M3a; M3B; M8b]** Rregullat dhe kërkesat e provimit, janë të përcaktuara në Rregulloren e universitetit **[3.0. Nenet 45-50]** dhe gjenden në faqen e internetit. Përmbledhtazi, oraret e provimeve publikohen paraprakisht; identitetet e studentëve kontrollohen gjatë provimeve dhe ka një procedurë për sekretimin e fletëve të provimit; rezultatet shpallen në mënyrë elektronike nga stafi akademik, por kodi i anonimitetit mbahet nga stafi administrativ; studentët kanë të drejtën e ankesës kundër shkeljeve procedurale gjatë provimeve dhe kanë mundësinë e rishikimit; **[Ev 3.0. Neni 51]** studentët mund të ankohen për notën e tyre dhe ankesa të tilla trajtohen me shpejtësi nga një komision i posaçëm **[3.0 Neni 52]** Studentët gjithashtu kanë të drejta të kufizuara për rivlerësimin e notës **[3.0 Neni 54]**
- 4.6 Stafi akademik dhe administrativ që takoi Grupi i Vlerësimit të Jashtëm, ishte i qartë për rolet e tyre përkatëse në vlerësimin dhe trajtimin e notave, **[M3a; M3B; M9]** dhe studentët ishin të kënaqur me aranzhimet në vlerësim, si edhe pohuan se këto marrëveshje ishin në përputhje me politikën e universitetit **[M3a; M3b]** Studentët ishin në dijeni se si të bënin ankesa **[M8a; M8b]** dhe mund të tregonin rastet ku notat ishin rishikuar si rezultat i një ankimi. **[M8a]**
- 4.7 Më shumë se gjysma e studentëve të anketuar për procesin e vlerësimit raportuan se studentët kopjojnë në provime, por stafi me të cilin u takua Grupi i Vlerësimit të Jashtëm **[M5]** nuk ishin në dijeni të kopjimit të përgjithshëm dhe Grupi nuk mund të përcaktonte përhapjen e kësaj praktike jo të mirë. Universiteti, në Rregulloren e tij, ka

procedura të përshtatshme që ndiqen në raste kopjimi, për të siguruar sigurinë dhe integritetin e vlerësimit, [3.0 Nenet 84-86] dhe disa pjesëtarë të stafit, [M7] por jo të gjithë, [M9] ishin në dijeni të tyre [Kapitulli, I, Standardi II.2]

- 4.8 NjSBC vlerëson stafin dhe programet, duke përfshirë përshtatshmërinë për tregun e punës, sipas termave të tij të referencës, [17.0] të cilat përfshijnë anketimin e studentëve [37.1-3; M1] për t'iu marrë mendimet në lidhje me module të veçanta, stafin dhe shërbimin e ofruar nga fakulteti. Në bazë të gjetjeve të saj, NjSBC-ja më pas do të hartojë plane veprimi. [RVV ; 17.0 Neni 8] Raporti i Vetëvlerësimit vuri në dukje se NjSBC-ja, gjithashtu ndikon në përmirësimin e programit, përmes kontributit të tij në Raportin vjetor për Veprimtarinë Akademike, Kërkimore dhe Financiare, [AE1.2; M1] megjithëse Grupi i Vlerësimit nuk e kishte të qartë se si të dhënat sasiore që përmban raporti mund të përdoren për përmirësimin e programeve.
- 4.9 Ndonëse disa të dhëna, mbi të cilat bazohet programi i përmirësimit të programeve, merren nga provimet shtetërore dhe organet e licencimit, programet [RVV] diskutohen në mbledhjet vjetore, [RVV; M9] nga të cilat propozimet për ndryshim i kalojnë dekanit të Fakultetit dhe Rektoratit, dhe më pas Senatit Akademik, për miratim. [M9; AE3.14] Universiteti dha dy shembuj të qartë, komunikimi mjekësor dhe kimia organike, ku ishte realizuar përmirësimi i cilësisë së mësimdhënies, secili në përgjigje të pjesëshme ndaj dëshirave të studentëve [AE4.2.1; AE4.2.2; M1] Studentët që takoi Grupi i Vlerësimit ishin në gjendje të jepnin shembuj shtesë, për shembull sigurimi i një periudhe prove shtesë dhe orë mësimore më praktike, kur programet u përmirësuan si përgjigje ndaj sugjerimeve të tyre. [M3a] Megjithatë, përmirësimet nuk realizohen si përgjigje ndaj studentëve, por mund të ndërmerren nga vetë universiteti dhe u ofrua edhe një shembull i tillë. [M3a]
- 4.10 Në krahasim me programet e tjera, përqindjet e kalueshmërisë në Infermieri janë vazhdimisht të ulëta, nën 80 për qind [37.4] Megjithëse në planin e veprimit, që rrjedh nga Raporti Vjetor i universitetit, parashikohet një pikë në lidhje me përmirësimin e normave të kalueshmërisë në përgjithësi, [AE1.3] stafi që takoi Grupi i Vlerësimit nuk ishte në dijeni të kësaj çështje dhe universiteti dëshiron të marrë parasysht marrjen e masave të veçanta, për të siguruar përmirësimin e normës së kalueshmërisë në Infermierinë.
- 4.11 Universiteti është në dijeni të bazës së tij të burimeve në lidhje me mësimdhënien dhe ka plane dhe arsytetime për përmirësim, siç është krijimi i një Qendre Simulimi, por ka kufizime në planin fiskal. [M1] Burimet shpërndahen pjesërisht kundrejt numrit të studentëve; kështu që së fundi u rekrutuan më shumë persona si staf akademik për në Infermieri, [M1] në bazë të një vlerësimi të përshtatshëm të qëndrueshmërisë afatgjatë të niveleve të rekrutimit të stafit. [M1]
- 4.12 Ka njëfarë vetëdijeje për punësueshmërinë e të diplomuarve, por kjo është në një fazë të hershme të zhvillimit dhe ende nuk është pjesë e procesit të përmirësimit të programit. Siç është shënuar edhe në pikën 5.12 më poshtë, Universiteti po kërkon të kuptojë më të mirë se ku punësohen të diplomuarit e vet dhe kjo do t'i mundësojë atij të shfrytëzojë të dhënat në shërbim të përmirësimit të programit. [Kapitulli, I Standardi II.3]
- 4.13 Raporti i Vetëvlerësimit nxori në pah se përmirësimi i cilësisë së mësimdhënies ishte përgjegjësi e NjSBC-së, që e realizon nëpërmjet anketimeve të studentët për sa i përket performancës së stafit. [M7; M8a] Grupi i Vlerësimit u vu në dijeni se cilësia e mësimdhënies monitorohet nga dekanët e fakultetit, duke u bazuar përsëri në reagimet e studentëve, [M4; M7] dhe se disa punonjës do të vëzhgojnë të tjerët, si një mjet për të përmirësuar aftësitë e tyre. [RVV] Stafi i ri akademik zakonisht emërohet fillimisht me

kohë të pjesshme [M7] dhe duhet të plotësojë një vit mësimdhënie përkrah një pedagogu me përvojë [M4 ; M7; M9] Megjithatë, mungesa e një pike krahasimi të praktikës, ose përdorimi i ekspertëve të mësimdhënies dhe mësimnxënies, e bën këtë proces potencialisht joefikas, pasi nuk ka asnjë garanci që përvoja barazohet në praktikën e efektshme. Megjithëse stafi me përvojë mund të përditësohet profesionalisht në mësimnxënie, mësimdhënie dhe vlerësim, duke marrë pjesë në konferenca, [M4; M7] përgjegjësia e vetëidentifikimit të çdo nevoje për përditësimin profesional i ngarkohet stafit.[M4]

- 4.14 Universiteti sigurohet që stafi akademik të jetë i kualifikuar në kërkimin shkencor, por nuk sigurohet që stafi të trajnohet në mënyrë të efektshme në mësimdhënie, dhe as nuk ofron ndonjë mbështetje në eksperimentimin e mësimdhënies. Mungesa e një qasjeje efektive në mbarë universitetin për nxitjen e përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë së mësimdhënies si për stafin e ri, ashtu edhe stafin me përvojë, është një **dobësi** dhe Grupi i Vlerësimit të Jashtëm është i mendimit se **Kapitulli, I Standardi II.4** nuk është përmbushur. Ai **rekomandon** që Universiteti të zbatojë një sistem të efektshëm dhe procedurat përkatëse, për të zhvilluar të gjithë stafin akademik në mësimdhënie, mësimnxënie dhe vlerësim, duke marrë parasysh praktikën më të mirë aktuale. [**Kapitulli, I, Standardi II.4**]
- 4.15 Duke pasur parasysh marrëdhënien e ngushtë me strukturat klinike, universiteti e përqendron kërkimin e tij në kujdesin e pacientit dhe zhvillimin e praktikës klinike në Shqipëri, më shumë sesa në shkencat themelore [M1; M2] Në përputhje me këtë, grupet kërkimore kanë tendencë t'iu përbahen prioriteteve kombëtare.[RVV] [**Kapitulli, II Standardi I.1**]
- 4.16 Departamenti është njësi bazë ku kryhet koordinimi i kërkimit, [M2; M4] dhe është ai që përcakton se në cilat fusha mund të zhvillohen studime doktorature. [M2] Stafi ka mundësinë që të propozojë kërkimet e veta, por është departamenti ai që miraton projektet dhe cakton fondet, [RVV] zakonisht përmes një procesi tenderimi [M7] Një koordinim i tillë është në përpjesëtim me punën, në partneritet me njësitë klinike dhe me garantimin e prioritetit të punës, kundrejt Shqipërisë dhe politikave shtetërore [M4] Koha për kërkim caktohet me anët të dialogut, bazuar në planet kërkimore. Universiteti mund të financojë gjithashtu drejtpërdrejt fushat me përparësi, për shembull sigurimin e laboratorëve të rinj të farmacisë dhe të materialeve të konsumit.[RVV] [**Kapitulli, II Standardi I.5. Kapitulli, II Standardi I.4**]
- 4.17 Ka partneritete me organe të tjera, kryesisht universitete, që përfshijnë veprimtarinë kërkimore, [21.0; 21.1] dhe në fokus mbetet përmirësimi i shëndetësisë në vend. [M1] Universiteti përfiton nga ky fokus, nëpërmjet marrëdhënieve të tij me partnerët klinikë. Këta partnerë i shprehën Grupit të Vlerësimit të Jashtëm entuziazmin e tyre për pjesëmarrjen në projekte të përbashkëta kërkimore dhe treguan sa tërësore ishte pjesëmarrja e tyre në suksesin e veprimtarive kërkimore të universitetit në një spektër veprimesh, që variojnë nga ofrimi i të dhënave deri në ndërhyrjet kirurgjikale. [M6] Financimi për veprimtari të tilla ka ardhur nga organet profesionale dhe nga njësitë klinike vendore.[M4; M7][**Kapitulli, II Standardi I.2; Kapitulli, II Standardi I.5; Kapitulli, II Standardi I.4**]
- 4.18 Universiteti është i përfaqësuar ndërkombëtarisht përmes veprimtarive të tij kërkimore. Ka pjesëmarrje të lartë në kërkimet bashkëpunuese ndërkombëtare, [GID; 23.0] që tregojnë qasje të mirë në burimet ndërkombëtare të financimit, përfshirë edhe nga Komisioni Evropian (Horizon 2020. [M4; M7] Stafi që takoi Grupin i Vlerësimit të Jashtëm ka shprehur krenari të madhe për veprimtaritë e tyre ndërkombëtare, [M4] në veçanti për bashkëpunimin e tyre me universitete të tjera evropiane. Përvoja me

kërkimin, cilësia dhe sasia e rezultateve kërkimore janë një faktor në emërimin e stafit. **[24.0] [Kapitulli, II Standardi I.3; Kapitulli, II Standardi I.5]**

- 4.19 Megjithëse pjesëmarrja në konferenca ndërkombëtare nga ana e stafit është e gjerë, **[25.1] vetëm** disa persona të stafit që u takuan me Grupin e Vlerësimit ishin rimbursuar nga universiteti për pjesëmarrjen e tyre. **[M7]** Organizimi i konferencave shkencore nga universiteti është i rëndësishëm (35 që nga viti 2010). **[AE3.4][Kapitulli, II Standardi I.3]**
- 4.20 Studentët, pjesërisht përmes Këshillit Studentor, kanë mundësi të kontribuojnë në konferencat e kërkimit shkencor, **[M3a; M4; M8a]** disa prej të cilave janë të organizuara posaçërisht për ta, **[26.1; AE1.2; 26.1; AE4.8.1]** dhe ata marrin kredite akademike për pjesëmarrjen. **[M3a]** Studentët e ciklit të tretë (mjekët praktikantë) përfshihen në mënyrë të shpeshtë në veprimtaritë kërkimore, duke përfshirë botimin. **[M8b]** Këto veprimtari janë tregues i një politike mbështetëse për promovimin e kulturës së kërkimit. **[Kapitulli, II Standardi 1.6]**
- 4.21 Një numër i konsiderueshëm i rezultateve të kërkimit botohen në planin ndërkombëtar **[25.1; 25.1.1]** dhe stafi pohoi se realizoheshin edhe botime në vend, duke përfshirë edhe ato në gjuhën shqipe, që gjë tregon një punë me përqendrim vendor ose që ka një ndikim më të vogël. **[M7]** Megjithëse ka tre revista mjekësore brenda institucionit, **[39.0; 39.1; 39.2; 39.3]** vetëm një është në anglisht dhe ndërkohë që kjo mund të kufizojë promovimin e punës, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm ishte i mendimit se sigurimi i aksesit për ata që nuk kanë njohuri të mjaftueshme të gjuhës angleze mund të jetë gjithashtu një karakteristikë pozitive. **[Kapitulli, II Standardi I.3; Kapitulli, II Standardi I.7]**
- 4.22 Në Raportin e Vetëvlerësimit, Universiteti vuri në dukje se NjSBC-ja ka një rol drejtues **[17.0]** në vlerësimin e veprimtarisë kërkimore, nëpërmjet kontributit të NjSBC-së në Raportin vjetor për Veprimtarinë Akademike, Kërkimore dhe Financiare. **[AE1.2]** Ky raport tregon angazhimin në organizimin e konferencave kombëtare dhe ndërkombëtare dhe në nxitjen dhe menaxhimin e bashkëpunimit ndërkombëtar në një sërë veprimtarish, si dhe dokumentimin e rezultateve kërkimore. Nga raporti është përpiluar një plan veprimi, **[AE3.1]** megjithëse disa nga pikat e plan veprimit nuk kanë cilësinë për të sjellë ndryshimin **[p.sh. # 8. # 9]** Monitorimi i veprimtarisë së stafit kryhet me anë të raporteve vjetore kërkimore të stafit **[25.0]** që, përmes raporteve të departamenteve, **[M7]** integrohen në Raportin Vjetor të Universitetit. **[M2]** Raportet e veçanta përdoren nga departamentet për të planifikuar mësimdhënien, që është e orientuar nga kërkimi.
- 4.23 Duke pasur parasysh se NjSBC-së është krijuar së fundmi, Universiteti është në një fazë të hershme të kuptimit sistematik të veprimtarisë të tij të përgjithshme të kërkimit, pikave të forta dhe rezultateve, dhe kjo kontribuon në pohimin e bërë në Fushën e Vlerësimit 1 në lidhje me NjSBC-në (shih pikën 1.8). Aktualisht, **Kapitulli, II Standardi I.8** nuk është përmbushur. Megjithatë, pasi raportimi i kërkimit të bëhet më i qëndrueshëm, universiteti do të jetë në gjendje të përcaktojë përparësitë dhe qëllimet, dhe të monitorojë ecurinë drejt tyre. **[Kapitulli, II Standardi I.8]**

Gjetje

Praktika e mirë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi karakteristika të praktikës së mirë.

Dobësi

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi dobësinë e mëposhtme:

- Mungesa e një qasjeje të efektshme në të gjithë universitetin, për të nxitur përmirësimin e vazhdueshëm në cilësinë e mësimdhënies si për stafin e ri, ashtu edhe për atë të vjetër (pikat 4.13 dhe 4.14; **Kapitulli, II, Standardi I.1**).

Rekomandime

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi rekomandimin e mëposhtëm:

- Universiteti duhet të zbatojë një sistem të efektshëm së bashku me procedurat përkatëse, për ta zhvilluar stafin akademik në mësimdhënie, mësimnxënie dhe vlerësim, duke marrë parasysh praktikatat e mira aktuale (pika 4.14; **Kapitulli, II, Standardi I.1**).

Pohim i veprimeve të ndërmarra

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk pohoi asnjë veprim.

Gjykimi

Standardet për Mësimdhënien, Mësimnxënien, Vlerësimin dhe Kërkimin janë përmbushur kryesisht.

Fusha e Vlerësimit 5: Studentët dhe Mbështetja e tyre

- 5.1 Pranimi i studentëve në universitet realizohet në përputhje me kuotat për programet e studimit të miratuara nga Ministria e Arsimit dhe Sportit. Proceset dhe kriteret e pranimeve janë në dispozicion në faqen e internetit të universitetit. Përveç kësaj, universiteti ndërmeret një sërë aktiviteteve në lidhje me pranimet, duke përfshirë panairë pune, takime javore të organizuara nga fakultetet në shkollat e mesme, këshillim për aplikantët dhe vizita në universitet nga aplikantët, për t'u njohur me stafin dhe studentët. **[M3b; M5; 27.1]**
- 5.2 Menjëherë pas regjistrimit, studentët marrin informacion nga një sërë mënyrash - online, nga departamenti nëpërmjet postës elektronike, nëpërmjet udhëzimeve të publikuara, **[M3a; M3B; 27.3]** dhe drejtpërdrejt nga stafi akademik. Në fillim të vitit akademik organizohet "Ceremonia e Bluzave të Bardha" **[27.2]** kur studentët simbolikisht marrin bluzën e tyre të bardhë dhe u jepet informacion për studimet, të drejtat dhe përgjegjësitë e tyre dhe detajet kontaktet e tyre brenda universitetit **[RVV fq.48]** Studentët me të cilët u takua Grupi i Vlerësimit të Jashtëm ishin të kënaqur me informacionin që kishin marrë kur po aplikonin në universitet dhe kur filluan studimet e tyre. **[M3b]**
- 5.3 Universiteti ka një raport të përshtatshëm midis stafit akademik dhe studentëve në masën 1:8 për studentët e ciklit të dytë dhe të tretë. **[M5] [Kapitulli, I Standardi III.1]**
- 5.4 Universiteti përdor një sërë mjetesh komunikimi me studentët, duke përfshirë faqen e tij të internetit, faqet e rrjeteve sociale, emailin, njoftimet në ekrane dhe posterat, udhëzimet dhe mbledhjet e rregullta. Dosjet personale për secilin studentët mbahen në kopje të shtypura në Sekretarinë Mësimore të secilit fakultet. **[RVV fq.49. M5]** Studentët pohuan se ishin të kënaqur me disponueshmërinë e informacionit dhe stafit. **[M3a; M3b] [Kapitulli, I Standardi III.2]**
- 5.5 Këshillat për studentët ofrohen nga një numër i konsiderueshëm i stafit të universitetit **[3.1 Neni 22; M3a; M7]** si dhe me anë të udhëzimeve të shpallura. **[27.3; 27.4]** Universiteti ka një procedurë të qartë për studentët që dëshirojnë të ndryshojnë programin e tyre të studimit dhe japin informacione për këtë, **[32 pika III; M8a]**, që gjithashtu publikohen në fillim të vitit të ri akademik. Përveç kësaj, universiteti ka edhe pozicionin e "Mbrotësit të Studentëve" në një fakultet, **[1 Neni 37]** ku një anëtar i emëruar i stafit akademik mbështet studentët dhe vepron si ndërmjetës, kur është e nevojshme. Studentët u shprehën se kishin përfituar nga ndihma e Mbrotësit kur ata kishin kërkuar të plotësonin një pyetësor për të dhënë mendimet e tyre. **[M9] [Kapitulli, I Standardi III.3]**
- 5.6 Studentëve nga grupet e pakicave, si, për shembull studentëve romë dhe egjiptianë ballkanikë, iu ofrohet mbështetje me anë të bursave dhe përjashtimit nga tarifatat e shkollimit në përputhje me dispozitat ligjore në vend. **[40; M9]** Universiteti gjithashtu synon në të ardhmen të ulë me 50 për qind tarifën për studentët e ciklit të dytë, që vijnë nga këto kategori të veçanta, një hap i cili është përtej kërkesave ligjore. **[M9] [Kapitulli, I Standardi III.4]**
- 5.7 Studentëve iu sigurohet një sasi e përshtatshme e materialeve online, buletineve dhe teksteve mësimore, nëpërmjet bibliotekës kryesore universitare, **[36.1; 36.2; 36.3. 43]** ku shumë libra janë në anglisht. Ka edhe biblioteka më të vogla, specifike për disa lëndë, dhe studentët pohuan se ata mund të aksesonin të gjitha materialet që u nevojiteshin. **[Turi në terren; M3b]** Biblioteka përditësohet vazhdimisht me mënyra të ndryshme, duke përfshirë botimet e institucionit. **[39; 39.1; 39.2; 39.3]** Studentët dhe

lektorët kanë anëtarësim falas në bibliotekë dhe janë të pajisur me një kartelë regjistrimi. **[Kapitulli, I, Standardi III.5]**

- 5.8 Mentorimi dhe tutorimi për studentët ofrohet gjatë gjithë vitit akademik, kryesisht nga stafi akademik, edhe pse studentët ishin të kënaqur që ata mund të shkonin edhe te Sekretaria e Departamentit ose zyra e Dekanit nëse kishin ndonjë pyetje apo vështirësi. **[M3b]** Si stafi, ashtu edhe studentët përshkruan një marrëdhënie të ngushtë me kontakte të shpeshta; stafi ishte i disponueshëm, dhe nuk ka shumë nevojë për formalizimin e takimeve të tyre. **[M9]** Në rastet kur studentët kanë probleme personale që ata nuk të dëshirojnë t'i ndajnë me një nga pedagogët e tyre, ata mund të flasnin me stafin specialist në pjesë të tjera të universitetit, për shembull me ata që kanë ekspertizë psikiatrike. **[M9] [Kapitulli, I Standardi III.6]**
- 5.9 Studentët përfaqësohen në organet drejtuese kryesore të universitetit, duke përfshirë Senatin, Këshillat e Fakultetit dhe Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, **[RVV fq.51]** dhe nxiten të angazhohen në vendimmarrje. Studentët u shprehën se ka mundësi të shumta për të ngritur çështje dhe që mund ta bëjnë këtë në mënyrë zyrtare, nëpërmjet përfaqësuesve të tyre në Senat dhe nëpërmjet Këshillit Studentor. **[M3a; M3b]** Një shembull për të treguar se çështjet e ngritura prej tyre ishin marrë në konsideratë nga Universiteti ishte kërkesa për mundësi shtesë për vlerësimin e rezultateve ("sezoni i provimeve"/minivjeshta). **[9.1; M3a; M3b]** Studentët u përfshinë plotësisht në përpilimin e Raportit të Vetëvlerësimit, duke mbledhur dokumente dhe duke dhënë feedback të dobishëm për procesin. **[M2]**
- 5.10 Këshilli Studentor, me përfaqësuesit e tij të zgjedhur nga të gjitha kurset, është shumë aktiv dhe vepron si "zëri" i trupës studentore në organizimin e aktiviteteve për studentët, disa prej të cilave në nivel ndërkombëtar. Këto aktivitete përfshijnë konferenca, **[26.1]** fushata ndërgjegjësuere dhe shkollat dimërore e verore **[26.2; M5; M8a]** Universiteti e mbështet financiarisht Këshillin Studentor dhe i ka siguruar atij një zyrë të vetën. **[M8a]** Në fillim të vitit, universiteti shqyrton programin e aktiviteteve që Këshilli Studentor dëshiron të ndërmarrë dhe zakonisht financon ato në masën rreth 30 për qind, ndërsa pjesa tjetër e financimit kryhet nga donatorët **[M5; M8a]** Studentët gjithashtu pohuan mbështetjen jo-financiare nga ana e universitetit, që i lejon të përdorë mjediset e universitetit, për të promovuar aktivitetet nëpër departamente dhe për të pasur mbështetjen dhe angazhimin e stafit. **[M8a] [Kapitulli, I Standardi III.7]**
- 5.11 Siç është përmendur edhe në pikën 2.4 më lart, një numër i madh aktiviteteve shoqërore, kulturore dhe komunitare organizohen nga stafi i universitetit dhe nga studentët me ndihmën e Këshillit Studentor. **[26.1; 26.2; M8]** Përveç kësaj, brenda universitetit, Këshilli Studentor po zhvillon projektin "Studentët për Studentët", nëpërmjet të cilit studentët më të vjetër me rezultate të mira mësojnë studentët e rinj. **[M8a] [Kapitulli, I Standardi III.8]**
- 5.12 Këshillimi për karrierën brenda universitetit zhvillohet nëpërmjet stafit akademik në fakultete dhe specialistëve në këtë fushë që janë në kontakt të ngushtë me praktikën dhe me studentët. Studentët me të cilët u takua Grupi i Vlerësimit të Jashtëm ishin të kënaqur me informacionin që kishin marrë në këtë mënyrë. **[M3a; M3b]** Njësia e Karrierës u krijua në Fakultetin e Mjekësisë në dhjetor të vitit 2016 dhe ka dy funksione kryesore: asistencën për zhvillimin e kurrikulave dhe këshillimin për karrierën. Projektet e saj të deritanishme përfshijnë "Të qenit student për një ditë", që nxënësit e shkollave të mesme të përjetojnë arsimin e lartë, dhe bashkëpunimin me agjencinë frankofone, e cila po ofron mundësi për zhvillimin e stazhit jashtë vendit. Njësia gjithashtu drejton anketimet dhe po punon për të përmirësuar të dhënat që kanë mbledhur për punësimin e të diplomuarve. **[M9]** Të dhënat e mbledhura nga Departamenti i Burimeve Njerëzore të universitetit tregojnë se shumica e të diplomuarve gjejnë punë në sektorin privat dhe

publik të shëndetësisë, **[RVV fq. 52; 37.7; 24.5]** duke përfshirë ata të punësuar nga vetë Universiteti dhe nga Spitali Universitar. Siç është përmendur në pikat 1.17 dhe 3.9 më lart, universiteti është i vetëdijshëm për kufizimet aktuale në lidhje me mbledhjen dhe analizën e të dhënave të punësimit të të diplomuarve. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm evidentoi se ka plane për riorganizimin e strukturave të përkushtuara për karriera, duke përfshirë integrimin e të dhënave të punësimit që momentalisht mbahen në fakultete dhe departamente. **[RVV fq.53; M9]** Grupi i Vlerësimit të Jashtëm pohon hapat që po merren në të gjithë universitetin, për të forcuar karrierën dhe mbledhjen e të dhënave statistikore për punësimin e të diplomuarve. **[Kapitulli, I Standardi III.9]**

Gjetje

Praktika e mirë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi karakteristika të praktikës së mirë.

Dobësi

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi asnjë dobësi.

Rekomandime

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk dha rekomandime.

Pohim i veprimeve të ndërmarra

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm pohoi se veprimet e mëposhtme po ndërmerren aktualisht:

- Hapat që po ndërmerren aktualisht nga Universiteti, për të forcuar mbështetjen ndaj karrierës dhe mbledhjen e të dhënave statistikore mbi punësimin e të diplomuarve (pikat 5.12. 3.9 dhe 4.12;
Kapitulli, I, Standardi III.9)

Gjykimi

Standardet për Studentët dhe Mbështetjen e tyre janë përmbushur plotësisht.

Lista e dokumenteve

| Renditja | Nr. i dokumentit | Titulli |
|----------|------------------|--------------------------------------------------------------------------------------------|
| 4 | 1.0 | Statuti i Universitetit të Mjekësisë, Tiranë |
| 5 | 2.1 | Strategjia e Zhvillimit, 2013-2016 e UMT-së. |
| 6 | 2.2 | Plani Strategjik 2017-2020. UMT. |
| 7 | 3.0 | Rregullore i Universitetit të Mjekësisë, Tiranë |
| 8 | 3.1 | Rregullore i Fakultetit të Mjekësisë |
| 9 | 4.0 | Rregullore e Këshillit të Profesorëve të Fakultetit të Mjekësisë, UMT. |
| 10 | 4.1 | Procedurat për marrjen e gradës shkencore dhe titujve akademikë në UMT (Shembuj). |
| 11 | 5.0 | Rregullore për Organizimin e Programeve të Doktoraturës të UMT-së. |
| 12 | 6.0 | Rregullore e Këshillit të Botimeve të UMT-së. |
| 13 | 6.1 | Tekst i miratuar nga Këshilli i botimeve të UMT-së. |
| 14 | 7.0 | Lista e mbledhjeve të Senatit Akademik të UMT-së, 2013-2016. |
| 15 | 7.1 | Lista e mbledhjeve të Senatit Akademik të UMT-së, 2013-2016. |
| 16 | 7.2 | Lista e vendimeve të Senatit Akademik të UMT-së, 2013-2016. |
| 17 | 7.3 | Procedura e ndjekur për mbajtjen e Mbledhjes së Senatit Akademik. |
| 18 | 7.3.1 | Shembuj konkretë – Mbledhje e Senatit Akademik. |
| 19 | 8.0 | Rregullore për Funkcionimin e Këshillit të Administrimit, UMT. |
| 20 | 8.1 | Lista e mbledhjeve të Bordit të Administrimit të UMT-së 2014-2016. |
| 21 | 8.2 | Lista e vendimeve të Bordit të Administrimit të UMT-së për vitet 2014-2016. |
| 22 | 8.3 | Procedura e ndjekur për mbajtjen e Mbledhjes së Këshillit të Administrimit. |
| 23 | 8.4 | Shembull konkret i një mbledhje e Këshillit të Administrimit.. |
| 24 | 9.0 | Statuti i Këshillit Studentor të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë |
| 25 | 9.1 | Shembull konkret – Kërkesë e Këshillit Studentor për sezon tjetër provimesh |
| 26 | 10.0 | Procedura e përgatitjes së projektbuxhetit afatmesëm. |
| 27 | 10.1 | Auditimi i Brendshëm nga Njësia e Auditit. |
| 28 | 10.2 | Auditimi nga Njësia e Auditit (Shembull MAS). |
| 29 | 10.3 | Shembull konkret – Miratimi i Buxhetit Vjetor. |
| 30 | 11.0 | Rregullore për Specializimet Afatgjata të Ciklit të Tretë në Shkencat Mjekësore të UMT-së. |
| 31 | 12.0 | Udhëzim për Pranimin dhe Regjistrimin në programet e specializimeve afatgjata 16-17. UMT. |
| 32 | 12.1 | Shembull i një Ankimi nga studentët për procesin e renditjes. |
| 33 | 13.0 | Lista e dokumentacionit të Departamentit. |
| 34 | 14.0 | Procedura për kriteret e pranimit dhe tarifat e shkollimit në UMT. |

| | | |
|----|------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| 35 | 14.1 | Shembull i miratimit të kriterëve për pranimin në programet e studimit 2017- 2018. |
| 36 | 14.2 | Shembull i miratimit të kuotave për Specializimet Afatgjata në UMT, 2016-2017. |
| 37 | 15.0 | Kodi i Etikës, Universiteti i Mjekësisë, Tiranë. |
| 38 | 15.1 | Rregullore për Funkcionimin e Bordit të Etikës, Universiteti i Mjekësisë, Tiranë. |
| 39 | 16.0 | Raporti për Veprimtarinë Akadematike, Kërkimore-Shkencore dhe Financiare të UMT-së për vitin 2016. |
| 40 | 16.1 | Raporti për Veprimtarinë Akadematike, Kërkimore-Shkencore dhe Financiare për vitin 2016 të Fakultetit të Shkencave Mjekësore Teknike |
| 41 | 16.2 | Pjesë e Raportit për Veprimtarinë Akadematike, Kërkimore-Shkencore dhe Financiare për vitin 2016 të Fakultetit të Mjekësisë Dentare |
| 42 | 17.0 | Rregullore për Funkcionimin e Njesisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. |
| 43 | 18.0 | Organigrama e UMT-së. |
| 44 | 18.1 | Organigrama e FM-së 2016. |
| 45 | 18.2 | Organigrama e Këshillit të Administrimit të UMT-së |
| 46 | 19.0 | Struktura e Stafit Akademik me kohë të plotë 2016-2017 të UMT-së. |
| 47 | 19.1 | Struktura e Stafit Akademik me kohë të pjesshme 2016-2017 të UMT-së. |
| 48 | 20.0 | Rregullore për praktikën e mësimdhënies, Fakulteti i Farmacisë (2014). |
| 49 | 20.1 | Rregullore për praktikën e mësimdhënies, Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike |
| 50 | 20.2 | Shembull-Marrëveshje për praktikën e mësimdhënies me institucione të tjera të Fakultetit të Shkencave Mjekësore dhe Teknike. |
| 51 | 20.3 | Shembull- Marrëveshje për praktikën e mësimdhënies me institucione të tjera të Farmacisë. |
| 52 | 21.0 | Lista e partneriteteve dhe bashkëpunimeve me universitete të tjera |
| 53 | 21.1 | Lista e partneriteteve dhe bashkëpunimeve me institucione të tjera |
| 54 | 21.2 | Shembull – Marrëveshje kombëtare dhe ndërkombëtare. |
| 55 | 21.3 | Shembull- Marrëveshje për diplomë të përbashkët |
| 56 | 22.0 | Lista e projekteve në rang kombëtare të UMT-së. |
| 57 | 23.0 | Projekte në nivel ndërkombëtar të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë. |
| 58 | 24.0 | Procedurë për punësimin e stafit në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë |
| 59 | 24.1 | Shembull i punësimit të stafit akademik në UMT. |
| 60 | 24.2 | Shembull i punësimit të stafit administrativ në UMT. |
| 61 | 24.3 | Kontratë pune, UMT. |
| 62 | 24.4 | Modeli i dosjeve nga Burimet Njerëzore (penalitetet dhe ankimimet). |
| 63 | 24.5 | Kontratë e studentit për programin e studimit të Specializimeve Afatgjata, UMT |
| 64 | 25.0 | Model i një shembulli i veprimtarisë kërkimore dhe lista e botimeve. |

| | | |
|-----|--------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| 65 | 25.1 | Lista e veprimtarive akademike dhe kërkimore të UMT-së. |
| 66 | 25.1.1 | Shembulli i veprimtarisë kërkimore dhe lista e botimeve. |
| 67 | 25.2 | Lista e veprimtarive të edukimit në vazhdim të UMT-së, QSUT. |
| 68 | 25.2.1 | Kërkesë e QKEV-së për stafin akademik si ekspert vlerësimi. |
| 69 | 25.3 | Telemjekësia. |
| 70 | 26.1 | Lista e veprimtarive profesionale, informuese dhe kërkimore-shkencore me studentët. |
| 71 | 26.2 | Lista e aktiviteteve kulturore dhe sportive me studentët. |
| 72 | 26.3 | Shembull i veprimtarisë shkencore, kulturore dhe sportive |
| 73 | 26.4 | Shembull –Financimi i veprimtarisë “Shkollë verore dhe shkollë dimërore”. |
| 74 | 26.5 | Shembull –Konferencë shkencore e organizuar nga Fakulteti i Farmacisë |
| 75 | 27.1 | Orientim për maturantët. |
| 76 | 27.2 | Java e orientimit për studentët e rinj. |
| 77 | 27.3 | Udhëzuesi i studentit të UMT-së |
| 78 | 27.4 | Udhëzuesi për Infrastrukturën e FM-së. |
| 79 | 27.5 | Historiku i Arsimit të Lartë Mjekësor në Shqipëri. |
| 80 | 28.0 | Lista e aseteve infrastrukturore të UMT-së së bashku me sipërfaqet e tyre në kornizë tabelle. |
| 81 | 28.1 | Lista e aseteve infrastrukturore të UMT-së së bashku me laboratorët dhe shërbimet e ofruara. |
| 82 | 28.2 | Plani i aseteve të UMT-së |
| 83 | 29.0 | Leja higjieno-sanitare. |
| 84 | 30.0 | Akti teknik nr. PMNZSH. |
| 85 | 31.0 | Spektori i Arkiv-Protokollit në Rektoratit e Universitetit të Mjekësisë, Tiranë. |
| 86 | 32.0 | Procedura për aplikimin e regjistrimit dhe transferimit të studentëve në UMT. |
| 87 | 32.1 | Shembull konkret i transferimit të studimeve në UMT. |
| 88 | 33.0 | Lista e programeve të studimit në UMT. |
| 89 | 34.0 | Procedurat për futjen e një programi të ri, ndryshimin ose rishikimin e një programi ekzistues në UMT |
| 90 | 35.1 | Kurrikula e programit të studimit të FM-së (PICD+SPA). |
| 91 | 35.2 | Kurrikula e programit të studimit për dy cikle të FMD-së (PICD+SPA) |
| 92 | 35.3 | Kurrikula e programit të studimit për dy cikle të FSHMT-së. |
| 93 | 36.1 | Lista e literaturës mësimore bazë për mbështetjen e dy programeve të Fakultetit të Mjekësisë. |
| 94 | 36.2 | Lista e literaturës mësimore bazë për mbështetjen e dy programeve të FMD-së. |
| 95 | 36.3 | Lista e literaturës mësimore bazë për mbështetjen e dy programeve të FSHMT-së. |
| 96 | 37.1 | Formularë Vlerësimi i studentëve për lëndën. |
| 97 | 37.2 | Formularë Vlerësimi i stafit administrativ në UMT. |
| 98 | 37.3 | Formularë Vlerësimi i studentëve për lëndën. |
| 99 | 37.4 | Performanca e studentëve të UMT-së në provimin e shtetit për licencimin. |
| 100 | 37.5 | Trajnimi i studentëve për tregun e punës. |
| 101 | 37.6 | Performanca e alumni, informacione nga Urdhri Profesional i Mjekëve. |
| 102 | 37.7 | Performanca e alumni, informacione nga Ministria e Shëndetësisë. |

| | | |
|-----|-------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| 103 | 38.0 | Lista e dhënies së titullit “Doktor Honoris Causa” nga UMT-ja |
| 104 | 38.1 | Lista e pedagogëve të huaj në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë. |
| 105 | 39.0 | Temat e Botimit Zyrtar Shkencor të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, AJMHS. |
| 106 | 39.1 | Lista e revistës shkencore botuar prej 3 vitesh nga FM. |
| 107 | 39.2 | Lista e revistës shkencore botuar prej 3 vitesh nga FMD. |
| 108 | 39.3 | Lista e revistës shkencore botuar prej 3 vitesh nga FSHMT. |
| 109 | 40.0 | Formulari i praktikës së heqjes së tarifës së shkollimit. |
| 110 | 41.0 | Praktika e monitorimit të procesit të të nxënit. |
| 111 | 42.0 | Ngarkesa mësimore e stafit akademik, planifikimi dhe rezultatet për vitin 2015-16, Fakulteti i Mjekësisë Dentare. |
| 112 | 43.0 | Biblioteka e Fakultetit të Mjekësisë. |
| 113 | 44.0 | GID UMT. |
| 114 | 45.1 | Kriteret e pranimit në programet e studimit të ciklit të parë dhe në programet e integruara të ciklit të dytë (fotografi e ekranit) |
| 115 | 45.2 | Sistemi i informacionit dhe shërbimit. ESSE3 (fotografi e ekranit) |
| 116 | 45.3 | Faqja e internetit e UMT-së (fotografi e ekranit) |
| 117 | 45.4 | Rrjetet sociale (fotografi e ekranit) |
| 118 | 45.5 | Lista e aplikantëve dhe fituesve në programin e studimit të Farmacisë për vitin 2016-17 (fotografi e ekranit) |
| 119 | 45.6 | Të dhëna për trajnimin nga ARTI (fotografi e ekranit) |
| 120 | 45.7 | Rekrutimi i stafit nëpërmjet faqes së internetit (fotografi e ekranit) |
| 121 | 45.8 | Agjencia Publike e Akreditimit të Arsimit të Lartë |
| 122 | 45.9 | Programet e studimit – informacione nga faqja e internetit |
| 123 | 45.10 | Kërkesa e departamentit për reagent. |
| 124 | 45.11 | Panairi i punës (fotografi e ekranit) |

Dokumente të mëtejshme (FE)

| Renditja | Nr. i dokumentit | Titulli |
|----------|------------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| 3 | 1.1 | Faqja e vjetër e internetit e UMT-së, datë 19.04.2017 dhe Faqja e re UMT-së, datë 22.04.2017 (fotografi të ekranit) |
| 4 | 1.2 | Raporti për Veprimtarinë Akademike, Kërkimore-Shkencore dhe Financiare për vitin 2016 e UMT-së. |
| 5 | 1.3 | Plan veprimi bazuar në Raporti Vjetor për Veprimtarinë Akademike, Kërkimore-Shkencore dhe Financiare. |
| 6 | 1.4.1 | Ngritja e grupit të punës për përpilimin e draftit të Statutit të UMT-së. |
| 7 | 1.4.2 | Shembull i buxhetit për kostot e reagentëve dhe materialeve për laboratorët , si edhe i investimeve për vitin 2017. |
| 8 | 1.7 | Rregullore për Specializimet Afatgjata të Ciklit të Tretë në Shkencat Mjekësore |
| 9 | 1.9 | Vendim nr. 539, datë 6.8.2014 i Këshillit të Ministrave dhe Vendim nr. 33, datë 19.9.2014 i Ministrisë së Arsimit dhe Sportit |
| 10 | 1.10 | Auditimi i brendshëm nga Njësia e Auditit. |
| 11 | 1.11.1 | Shembuj të propozimeve të ministrive për nevojat e Specializimeve Afatgjata |
| 12 | 1.11.2 | Panairi për tregun e punës. |
| 13 | 2.2 | Auditim nga Njësia e Jashtme e Auditit. |

| | | |
|----|-------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| 14 | 2.5 | Raport për mosdiskriminimin në procedurat e punësimit në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë. |
| 15 | 2.6.1 | Projektet në nivel ndërkombëtar |
| 16 | 2.6.2 | Shembull i Raportit të Rezultateve për përmbylljen e suksesshme të mobilitetit të studentëve. |
| 17 | 2.8 | Shembuj të performancës së stafit. |
| 18 | 2.9 | Shembuj të raporteve për pyetësorët. |
| 19 | 3.1 | Suplementet e diplomës (Mjekësia e Përgjithshme, Stomatologjia, Fizioterapia, Teknik Laboratori). |
| 20 | 3.4 | Lista e Konferencave të UMT-së në vitet 2010-2017 |
| 21 | 3.5 | Punësimi i studentëve në tregun ndërkombëtar. |
| 22 | 3.7 | Shembuj të kurrikulës dhe orareve për modulet e edukimit në vazhdim. |
| 23 | 3.13 | Hapat që ndiqen për miratimin e Gradës Doktorantë. |
| 24 | 3.14 | Shembull i procedura për përmirësimin e programeve të studimit të Masterit të Shkencave në Stomatologji. |
| 25 | 4.2.1 | Studim rasti i Përmirësimit të Mësimdhënies – Kursi i komunikimit mjekësor për studentët e vitit të parë të Mjekësisë. |
| 26 | 4.2.2 | Studim rasti i Përmirësimit të Mësimdhënies – Kimia organike. |
| 27 | 4.4 | Raportimi i auditimit për procesin mësimor. |
| 28 | 4.5 | Informacione dhe të dhëna të përgjithshme për UMT-në. |
| 29 | 4.6 | Buxheti për qëllime kërkimore në UMT. |
| 30 | 4.8 | Lista e veprimtarive profesionale, informuese dhe kërkimore-shkencore me studentët. |
| 31 | 4.8.1 | Shembuj të veprimtarive të kryera nga Universiteti i Mjekësisë, Tiranë |

Dokumente shitesë (AE)

| Renditja | Nr. i dokumentit | Titulli |
|----------|------------------|--------------------------------------------------------------------------------------------------|
| 1 | 1.0 | Rishikimi i Programit të Studimit të Farmacisë dhe Tregut të Punës |
| 2 | 2.0 | Lista e pajisjeve dhe reagentëve për veprimtaritë kërkimore për farmacinë dhe stomatologjinë |
| 3 | 3.0 | Vendim i Senatit Akademik për nivelin e gjuhës së huaj |
| 4 | 4.0 | Përpilimi, zbatimi dhe ndjekja e Plan Veprimit |
| 5 | 5.0 | Vlerësimi i Këshillit të Etikës |
| 6 | 6.0 | Procesverbalet e Departamentit të Farmacisë dhe Mjekësisë Dentare për përmirësimin e kurrikulave |
| 7 | 7.0 | Organigrama e strukturës së NjSBC-së |
| 8 | 8.0 | Tregu i punës i UMT-së. |
| 9 | 9.0 | Mobiliteti i studentëve nga UMT |
| 10 | 3.1 | Tabela 1 me Vendimin e Senatit Akademik për nivelin e gjuhës së huaj |
| 11 | 10.0 | Rregullore e UMT-së |
| 12 | 11.0 | Rregullore e Fakultetit |
| 13 | 12.0 | Ngarkesa mësimore e stafit akademik 2015-2016, deklarata për MAS |
| 14 | 13.0 | Anketimi i plotësuar nga studentët dhe stafi |
| 15 | | sekretaria _ shërbime dhe raporte (fotografi e ekranit) |
| 16 | | sekretaria _menaxhimi i studentëve (fotografi e ekranit) |

| | | |
|----|------|---------------------------------------------------------|
| 17 | | sekretaria profilet e studentëve (fotografi e ekranit) |
| 18 | | sekretaria_ kalendari i provimeve (fotografi e ekranit) |
| 19 | | sekretaria_ lista e notave (fotografi e ekranit) |
| 20 | | sekretaria_ raporte statistikore (fotografi e ekranit) |
| 21 | | profili i lidhjes së studentëve (fotografi e ekranit) |
| 22 | | portal i studentëve (fotografi e ekranit) |
| 23 | | studentët_ lista e notave (fotografi e ekranit) |
| 24 | | studentët _ tarifa e shkollimit (fotografi e ekranit) |
| 25 | | studentët _informacione të tjera (fotografi e ekranit) |
| 26 | 14.0 | e-portal i studentëve (fotografi e ekranit) |
| 27 | 15.0 | e-portal i sekretarisë (fotografi e ekranit) |

Mbledhjet

| | |
|----|------------|
| M1 | Mbledhja 1 |
| M2 | Mbledhja 2 |
| M3 | Mbledhja 3 |
| M4 | Mbledhja 4 |
| M5 | Mbledhja 5 |
| M6 | Mbledhja 6 |
| M7 | Mbledhja 7 |
| M8 | Mbledhja 8 |
| M9 | Mbledhja 9 |